



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
në
“Menaxhim në Sport dhe Turizëm”
ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti i Sporteve të
Tiranës"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asc. Edmond Biçoku

2. Dr. Enis Fita

Korrik/2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Sporteve të Tiranës”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Sporteve të Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit
3	Emërtimi i programit të studimit:	“Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS Nr. 395, datë 05.09.2017
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 294, datë 23.08.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim Nr.25, datë 13.07.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë i Studimeve
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 (një) vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	13 PAE / 0 PAK v.a. 2024-2025 13 PAE / 0 PAK v.a. 2023-2024 11 PAE / 0 PAK v.a. 2022-2023
18	Numri i studentëve:	20 Studentë v.a. 2023-2024 13 Studentë v.a. 2022-2023 21 Studentë v.a. 2021-2022
19	Komente / të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Sporteve të Tiranës ka filluar aktivitetin e tij akademik bazuar në VKM. Nr.123 Dt. 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës". Masteri Profesional në "Menaxhim në Sport dhe Turizëm" është një nga programet e studimit që ofrohet në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, pjesë e Universitetit të Sporteve të Tiranës. Ky program studimi i hapur me Urdhër Nr. 395 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, datë 05.09.2017 ofrohet pa ndërprerje që prej vitit akademik 2017-2018. Programi Master Profesional në "Menaxhim në Sport dhe Turizëm" e ka marrë akreditimin e parë nga Bordi i Akreditimit të ASCAL me Vendim Nr.25, datë 13.07.2018.

Struktura Akademike e Universitetit të Sporteve të Tiranës është organizuar me katër Njësi Kryesore:

1. Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes;
2. Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit;
3. Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit;
4. Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit;

Gjatë viteve, struktura akademike e UST-së i është nënshtruar ndryshimeve dhe përmirësimeve, ndër të cilat spikasin ato që lidhen me fuqizimin e veprimtarisë së pavarur të njësisë bazë, forcimin e rolit koordinues në nivel njësie kryesore e IAL-je si dhe përmirësimin e administrimit dhe strukturën organizative të UST-së.

Një arritje në aspektin e hapjes së programeve të reja të studimit për këtë institucion ka qenë hapja me Urdhër Nr. 395 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, datë 05.09.2017, "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë Masteri Profesional në "Menaxhim në Sport dhe Turizëm".

Programi studimit është hapur pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Departamenti i "Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit". Ky program studimi funksionon në përputhje me Ligjin 80/2015 "Ligji për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, detyrimeve të procesit të Bolonjës dhe sfidave të garantimit të cilësisë në çdo hallkë e aktivitet të tij, misionin dhe vizionin e UST-së.

Masteri i Ciklit të Dytë "Menaxhim në Sport dhe Turizëm" është një program akademik i orientuar dhe fokusuar drejt tregut të punës, i cili synon të mudësojë një përgatitje profesionale në aplikimin dhe zbatimin e parimeve të biznesit në fushën e sportit dhe turizmit aktiv, sportiv dhe atij të aventurës. Të diplomuarit në këtë program studimi kanë mundësi të padiskutueshme punësimi në kompani private dhe publike, në menaxhimin e qendrave të mirëqenies, fitnesit dhe aktivitetit fizik për nevoja të veçanta, në sektorin e shërbimeve shoqërore, organizative shkollore, zbavitje dhe argëtim, deri te menaxhimi i njësisë të sportit elitare dhe në industrinë e turizmit sportiv dhe atij të aventurës.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Universiteti i Sporteve të Tiranës, në përmbushje të detyrimeve ligjore, ka aplikuar në ASCAL më datë 20.02.2024 (Shkresë e IAL Nr. 1454/3 Prot, dërgon formularin e aplikimit - regjistruar në protokollin e ASCAL Nr. 142 Prot., datë 20.02.2024. Aplikimi është kryer pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), në përputhje me parashikimet e Manualit: “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”, i ndryshuar. Me kryerjen e aplikimit, UST-ja ka realizuar procesin e vlerësimit të brendshëm dhe nëpërmjet shërbimit në AMS ka nisur raportin e vlerësimit të brendshëm (RVB) dhe dokumentacionin mbështetës, pjesë e Dokumentacionit të Vetëvlerësimit të programit (DVV).

Raporti i vlerësimit të brendshëm është përgatitur nga një grup pune i ngritur me Vendimin e Dekanit të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Nr. Prot. 1470/3, datë 11.11.2024, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, si dhe me Statutin dhe Rregulloren e UST-së. dhe është konfirmuar vërtetësia e dokumentacionit të përdorur nga GVB për hartimin e RVB. Po kështu ky proces është bazuar edhe në Urdhërin e ASCAL Nr. 124, dt. 11.12.2024 “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti i Sporteve të Tiranës” ku theksohet se Ekspertë Vlerësimi të Jashtëm janë përzgjedhur: Prof.As. Edmond Biçoku; Dr. Dr. Enis Fita. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, (GVJ) është mbështetur në këtë proces nga koordinatori teknik i ASCAL Msc.Muhamed Prezja.

Në punën për hartimin e Raportit, Grupi i ekspertëve të jashtëm ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, në mënyrë të veçantë udhëzimet e ASCAL-it, si edhe ka shfrytëzuar dokumentat e brendshme të UST-së të vëna në dispozicion nga sistemi AMS. Ecuria e procesit të vlerësimit ka vazhduar në përputhje me agjendën e punëve të përcaktuara nga ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm zhvilloi dhe vizitën në institucion në datë 20-21 Janar 2025 ku mori takime të rëndësishme me aktorët kryesorë të këtij programi studimi duke filluar me Dekanin e Përgjegjësën e njësisë bazë, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi, me personelin administrativ, sekretarinë mësimore, bibliotekën dhe më pas vizitoi ambientet e UST-së dhe ambientet ku realizohet mësimdhënia teorike e praktike për këtë program studimi. Pas vizitave në UST, grupi i punës filloi hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm në përputhje me të gjitha templates apo guidën e hartimit të tij.

Me datë 23.06.2025, GVJ dergoi draft raportin e vlerësimit të jashtëm pranë UST-së nëpërmjet sistemit AMS. Me datë 25.06.2025, UST shprehu dakordësinë e saj në lidhje me raportin dhe nuk kishte asnjë koment rreth përmbatjes së tij. Për pasojë, raporti më poshtë është mendimi përfundimtar i GVJ-së në lidhje me këtë program studimi, shoqëruar edhe me analizën SWOT.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 25, datë 13.07.2018 janë:

- a. Universiteti duhet të adresojë si çështje prioritare krijimin e një njësie të brendshme mbikëqyrëse për vlerësimin e brendshëm të aktiviteteve të veprimtarisë së tij institucionale, si dhe identifikimin e konsulentëve të jashtëm në ndihmë të këtyre proceseve.
- b. Universiteti duhet të rishikojë menaxhimin e sistemit të tij të informacionit për të siguruar se informacioni dhe të dhënat janë strategjike dhe të përshtatshme
- c. Universiteti duhet të adresojë dhe të zbatojë politikë për pranimin, mbështetjen dhe për t'u siguruar studentëve me aftësi të kufizuara aksesin në të gjitha mjediset e mësimdhënies dhe mësimnxënies
- d. Institucioni duhet të adresojë si çështje prioritare sigurimin e një infrastrukture të përshtatshme në nivel universiteti, për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, si dhe të rishikojë menaxhimin e kësaj infrastrukture që të jetë e përshtatshme për kryerjen veprimtarisë mësimore
- e. Universiteti duhet të ngrejë dhe zbatojë krijimin e një baze të dhënash gjithëpërfshirëse dhe të përhershme për të ndjekur punësimin e të gjithë studentëve të diplomuar
- f. Universiteti duhet të parashikojë mbështetje financiare për aktivitetet e Këshillit studentor

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni:

- a. Universiteti duhet të adresojë si çështje prioritare krijimin e një njësie të brendshme mbikëqyrëse për vlerësimin e brendshëm të aktiviteteve të veprimtarisë së tij institucionale, si dhe identifikimin e konsulentëve të jashtëm në ndihmë të këtyre proceseve.
[Evidenca R.1.1 Vendimi i Senatit Akademik për ngritjen e NJSBC], [Evidenca R.1.2 Vendimi për përcaktimin e konsulentëve të jashtëm], [Evidenca R.1.3 Vendimi për emërimin e anëtarit student], [Evidenca ANEKS TABELAT PËRMBLEDHËSE, Tabela 24].
E plotësuar.
- b. Universiteti duhet të rishikojë menaxhimin e sistemit të tij të informacionit për të siguruar se informacioni dhe të dhënat janë strategjike dhe të përshtatshme.
[Evidenca R.2.1 Kontrata e shërbimit me KemiNet], [Evidenca R.2.2 Kontrata me RASH], [Evidenca R.2.3.1 Format tip për stafin akademik; Evidenca R.2.3.2 Format tip për studentët], [Evidenca R.2.3.3 Format tip për realizimin e kohës



vjetore të punës; Evidenca R.2.3.4 Format tip për tarifat e shkollimit; Evidenca R.2.3.5 Format tip për kontratat e prokurimit; Evidenca R.2.3.6 Format tip për studentët me bursë], [Evidenca R.2.4 Marrëveshje bashkëpunimi me UBT].

E plotësuar.

- c. Universiteti duhet të adresojë dhe të zbatojë politikë për pranimin, mbështetjen dhe për t'u siguruar studentëve me aftësi të kufizuara aksesin në të gjitha mjediset e mësimdhënies dhe mësimnxënies

[Evidenca R.3.1 Vendimi i Seanatit Akademik për miratimin e kuotave për vitin akademik 2024-2025], [Evidenca R.3.2.1 VKM, nr.40, datë 23.01.2019], [Evidenca R.3.2.2 VKM, nr.39, datë 23.01.2019], [Evidenca R.3.3 Foto evidencë për përshtatjen e infrastrukturës].

E plotësuar.

- d. Institucioni duhet të adresojë si çështje prioritare sigurimin e një infrastrukture të përshtatshme në nivel universiteti, për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, si dhe të rishikojë menaxhimin e kësaj infrastrukture që të jetë e përshtatshme për kryerjen veprimtarisë mësimore.

[Evidenca R.4.1 Përmirësimet në Infrastrukturë], [Evidenca R.4.2 Projektet infrastrukturore].

E plotësuar.

- e. Universiteti duhet të ngrejë dhe zbatojë krijimin e një baze të dhënash gjithëpërfshirëse dhe të përhershme për të ndjekur punësimin e të gjithë studentëve të diplomuar.

[Evidenca I.14 Organigrama e Universitetit], [Evidenca II.16 Informacion nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikut dhe Studentëve; Evidenca II.16.1 Të dhëna statistikore nga Sektori i Alumnit për ecurinë e punësimit 2022-2024].

E plotësuar.

- f. Universiteti duhet të parashikojë mbështetje financiare për aktivitetet e Këshillit studentor.

[Evidenca II.22 Vendim i Bordit të Administrimit për Miratimin e Regjistrimit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike], [Evidenca V.7 Pagesa e anëtarësimit të Shoqatës sportive të UST në Federatën shqiptare të Sportit Universitar].

E plotësuar.

Në gjykimin tonë, mbështetur dhe në dokumentacionin e ofruar jemi të mendimit që të gjitha Rekomandimet e Bordit të Akreditimit për këtë program studimi janë plotësuar me seriozitet nga njëjësia bazë dhe ajo kryesore.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në
“Menaxhim në Sport dhe Turizëm” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë
“Universiteti i Sporteve të Tiranës”**

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Sporteve të Tiranës është institucion i Arsimit të Lartë, i njohur me ligj si i tillë. Veprimtaria e tij bazohet në Nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në Ligjin Nr. 80/2025 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH”, në Statut dhe rregulloret e miratuara në zbatim të tyre. Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” ofrohet në pajtim me interesat kombëtare dhe synon të kultivojë tek studentët, ndër të tjera, vlerat akademike, kulturore e kombëtare, në përputhje dhe me misionin e UST-së të përcaktuara qartë në Statutin e UST-së sipas të cilit “Programi është në harmoni të plotë me interesat kombëtare të vendit në fushën ekonomike, politike, sociale, kulturore, sportive, gjeopolitike” etj. <i>- Evidenca I.1 Statuti i Universitetit të Sporteve të Tiranës, Neni 4, Neni 5</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Universiteti i Sporteve të Tiranës ka si mision të krijojë, transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe shërbimeve si dhe të nxisë e të zhvillojë edukimin fizik dhe sportet. Gjithashtu, UST-ja ka si mision të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj. Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, duke synuar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies për të formuar specialistë të aftë, të rrisë cilësinë e kërkimit shkencor, si edhe të përmirësojë shërbimet ndaj studentëve, qëllime të cilat janë në një linjë me Statutin e UST-së dhe Rregulloren e Studimeve në FVFR në të cilën përcaktohet qartë se

	misioni i Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit është “Nxitja dhe zhvillimi i aftësisë për kërkime shkencore, të mendimit kritik e analitik, ndjenjës së përgjegjësisë e angazhimit ndaj njeriut, komunitetit, kulturave, problemeve dhe çështjeve të ndryshme, që shqetësojnë individin e komunitetin.”. - <i>Evidenca I. Statuti i Universitetit, Neni 4, Neni 5</i> - <i>Evidenca I.2 Planit Strategjik i Zhvillimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës 2021-2026, Vizioni, Misioni, Parimet, Vlerat</i> - <i>Evidenca I.3 Planit i zhvillimit të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit</i> - <i>Evidenca I.4 Urdhri i hapjes së Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm</i> - <i>Evidenca I.5 Rregullore e Programit të studimit , Neni 3</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Në Strategjinë e zhvillimit të programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” theksohet “Programi synon të ofrojë një formim të thelluar profesional në sektorët kryesorë të sportit dhe turizmit, i cili do të shërbejë për studentët e diplomuar në këtë program studimi, si në aspektin e punësimit, edhe si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në programe të tjera të studimeve në këtë degë apo programe të tjera integruese që japin mundësi pune sipas kërkesave të tregut”. Ai është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të UST-së, Statutin e UST-së dhe me Rregulloren e FVFR-së. Si përfundim GVJ del në përfundimin se strategjia e zhvillimit të programit të studimit, si pjesë e strategjisë së përgjithshme të institucionit garanton përputhshmërinë e objektivave në nivel institucional. - <i>Evidenca I.2 Planit Strategjik i UST</i> - <i>Evidenca I.1, Statuti, Neni 5, pika b</i> - <i>Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 3, pika 2</i> - <i>Evidenca I.7 Platforma Institucionale e Kërkimit Shkencor të UST</i> - <i>Evidenca I.1 Statuti, Neni 5</i> - <i>Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit, Neni 3</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit	Jemi dëshmitarë që një nga degët më të fuqishme të ekonomisë shqiptare e cila gjithnjë e më shumë po zë një peshë dominuese në peshën e saj në gjenerimin e të ardhurave dhe në GDP-në kombëtare, dikton apo kushtëzon nevojën e përgatitjes të specialistëve të aftë për tregun e punës në nivel kombëtar, rajonal apo ndërkombëtar. Në vendin tonë, sektori i turizmit bazuar dhe




mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	në zhvillimin dhe interesin kombëtar dhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, konsiderohet si një nga sektoret prioritare të zhvillimit të vendit. Programi i studimit të Ciklit të dytë “Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, ka si qëllim të ofrojë një formim të thelluar profesional dhe synon të kontribuojë në arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm të ekonomisë shqiptare dhe më specifikisht të industrisë së sportit dhe turizmit, duke përgatitur specialistë të fushës, të aftë për të zbatuar me sukses strategjitë dhe politikat e turizmit të qëndrueshëm si të turizmit aktiv, atë sportiv dhe të aventurës.			
Konkluzione	- Evidenca I.5. Rregullore e Programit të Studimit, Neni 3. Si GVJ jemi të mendimit që programi i studimit “Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm” ofrohet në pajtim me interesat kombëtare dhe synon të kultivojë tek studentët, ndër të tjera, vlerat akademike, kulturore e kombëtare, në përputhje dhe me misionin e UST-së të përcaktuara qartë në Statutin e UST-së dhe është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të UST-së, dhe me Rregulloret e FVFR-së. Na rezultojnë se emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit “Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm” ofrohet në përputhje me fushën e drejtimet akademike të institucionit, klasifikimin dhe kodifikimin e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion jep një informacion të plotë të kapaciteteve dhe burimeve të nevojshme për të ofruar këtë program studimi. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit i cili ka tashmë një eksperiencë të suksesshme 15 vjeçare. Stafit akademik efektiv zotëron përvojën e duhur në mësimdhënie për t'u angazhuar në këtë program studimi. Mosha e stafit akademik është e balancuar gjë e cila mundëson shkëmbimin e përvojës dhe kualifikimit. CV-të e stafit akademik pasqyrojnë qartë angazhimin e tyre në

	shkëmbime dhe kualifikime të shumta brenda dhe jashtë vendit, si dhe botime shkencore në një numër të konsiderueshëm revistash të indeksuara brenda dhe jashtë vendit. Raporti i MAS mbi verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga UST, vërteton se ky institucion ka kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore të mjaftueshme të cilat janë një faktor i rëndësishëm në mbarëvajtjen e këtij programi studimi. - Evidenca I.8 Urdhri i hapjes së Universitetit të Sporteve të Tiranës - Evidenca I.9 Vendim i akreditimit institucional periodik
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Shqyrtimi i dokumentacionit, konfirmon se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, është tërësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Njesisë Kryesore (FVFR). Realizimi i këtij programi studimi mundësohet nga bashkëpunimi i 3 (tre) departamenteve të FVFR-së dhe përfshirja e stafit akademik të punësuar me kohë të plotë dhe të pjeshme të kualifikuar në fushën e menaxhimit dhe turizmit. Konfirmojmë se ka një rezonancë të fuqishme mes tre njësive bazë, gjë që garanton cilësinë e përmbushjes së programit të studimit. Njësia bazë, Departamenti i Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit (DMST) ka propozuar kodifikimin kombëtar të programit të studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm dhe është në pritje të miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). - Evidenca I.1 Statuti, neni 4, 5 - Evidenca I.3 Plani i zhvillimit të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit - Evidenca I.10 CV e stafit akademik të angazhuar për programin e studimit - Evidenca I.11 Procedura për kodifikimin e programit të studimit
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore,	Shqyrtimi i dokumentacionit, konfirmon se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, është tërësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Njesisë Bazë (DMST-së). Programi i studimit Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” është program i nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është hartuar në përputhje me misionin e UST-së. Konstatojmë se ka një bashkëveprim dhe koordinim shumë të mire

të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	mes tre njësite bazë, gjë që garanton cilësinë e përmbushjes së programit të studimit. Në Statutin e UST-së përcaktohen njësitë kryesore dhe njësitë bazë të UST-së, si dhe në Rregulloren e UST-së përcaktohet organizimi i brendshëm. - <i>Evidenca I.1 Statuti, neni 5, 6</i> - <i>Evidenca I.3 Plani i zhvillimit të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit</i> - <i>Evidenca I.10 CV e stafit akademik të angazhuar për programin e studimit</i> - <i>Evidenca I.1 Statuti, Neni 10; Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 4</i>			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Nuk Aplikohet.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në UST prej disa vitesh është ngritur Qendra e Trajnimit dhe Formimit të Vazhduar, e cila ofron trajnim të vazhduar profesional për të diplomuarit në programet e studimit që ofron. Një rol shumë të rëndësishëm luan edhe Sektori i Karrierës, Alumnit dhe Marrëdhënieve me Studentët i cili bashkëpunon me partnerë dhe koordinon dhe mundëson pjesëmarrjen e studentëve në takime të ndryshme me kompani e punëdhënëse, trajnime e ëorkshop-e dhe është synuar që të shkohet në resorted dhe bizneset më elitare të turizmit aktiv, sportive dhe të aventurës. - <i>Evidenca I.12 Vendimi i Senatit për Riorganizimin e Qendrës së Trajnimeve dhe Formimit të Vazhduar; Evidenca I.12.1 Vendimi i Komisionit të Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit; I.12.2 Modele certifikatash.</i> - <i>Evidenca I.13 Informacion nga Sektori i Karrierës dhe Alumnit</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton që struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me fshën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion, me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimet të studimeve si dhe kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	GVJ, konstaton se Njësia bazë - DMST më qëllim që të ofrojë në mënyrë sa më korrekte, shkencore e bashkëkohore programin e studimit, si dhe të sigurojë mbarëvajtjen e tij vendos marrëdhënie bashkëpunimi edhe me departamentet e tjera në FVFR, si; Departamenti i Veprimtarisë Fizike, Rekreacionit dhe Turizmit dhe Departamenti Lëvizja dhe Shëndeti. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve institucionale reciproke mes njësive bazë dhe atyre kryesore, Departamenti i Menaxhimit në Sport dhe Turizëm përpara fillimit të vitit akademik i paraqet këtyre njësive bazë kërkesën për pedagogë, për të ofruar lëndët specifike në programin e studimit Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”. Pjesë përbërëse e procesit të monitorimit të vazhdueshëm është dhe NJSBC-ja, e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e mësimdhënies dhe të proceseve të lidhura me të. Gjithashtu, për të siguruar cilësinë e vazhdueshme në ofrimin e programit të studimit në departament bëhet dhe analiza e punës mësimore dhe shkencore e personelit. - Evidenca I.1 Statuti, Kreu I, II, III dhe IV; Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Nenet 3–21, 23–27 - Evidenca I.1 Statuti i Universitetit, Neni 13, Neni 38, 39; Evidenca I.14 Organigrama e Universitetit; Evidenca I.15 Organigrama e Fakultetit - Evidenca I.16. Raporti vjetor i Universitetit për vitin akademik 2022-2023 - Evidenca ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Tabela 4 (Angazhimi i personelit akademik, lëndët dhe ngarkesa përkatëse; Evidenca I.17 Praktikë bashkëpunimi me njësitë brenda UST.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e GVB-së, ne si GVJ, konstatojmë se për përmbushjen e objektivave mësimore e formuese të studentëve, DMST-ja ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme me synim dhe qëllim zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve në kompani e biznese me object turizmin aktiv dhe atë sportiv. UST

institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	disponon një sërë marrëveshesh bilaterale me institucione homologe si brenda dhe jashtë vendit sidomos në kuadër të ndërkombëtarizimit. Ky fakt reflektohet drejtpërdrejtë, në mundësinë e stafit për të qenë pjesë e mobiliteteve, trajnimeve, pjesëmarrjes në aktivitete dhe projekte kërkimi, zhvillimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në veçanti GJVJ konstaton se ka marrëveshje në funksion të programit të studimit me institucione që disponojnë të gjitha mundësitë dhe investime serioze bashkëkohore për realizimin me sukses nga ana e studentëve të praktikave mësimore profesionale. Aktivitetet e kryera në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit pasqyrohen edhe në raportet vjetore institucionale. - <i>Evidenca I.2 Plani strategjik i UST</i> - <i>Evidenca I.18 Strategjia e UST për Ndërkombëtarizimin 2024-2028j.</i> - <i>Evidenca I.19 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UST;</i> - <i>Evidenca I.20 Lista e projekteve të Universitetit;</i> - <i>Evidenca I.21 Lista e mobiliteteve të Universitetit</i> - <i>Evidenca I.16 Raporti vjetor i Universitetit viti akademik 2022-2023</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Konstatohet që UST ka një numër marrëveshesh me institucione homologe si brenda ashtu edhe jashtë vendit duke ndjekur një politikë hapje institucionale për shkëmbime eksperiencash, programesh e stafesh akademike. Ai e ka përcaktuar këtë politikë bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj në dobi të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit që ofron. UST ka një rrjet marrëdhëniesh bashkëpunimi e partneritetesh nëpërmjet të cilëve organizon vizita studimore, praktikat profesionale të studentëve, punë vullnetare në komunitet, etj. UST ka lidhur marrëveshje për praktikat profesionale që zhvillohen në terren, në institucione sportive dhe ekonomike, në agjenci shtetërore, sipërmarrje private, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogëve të caktuar nga departamenti përkatës. Departamenti në koordinim të plotë me njësinë kryesore, u mundëson studentëve kryerjen e praktikës mësimore sipas specifikave, duke bashkërenduar veprimtarinë praktike në institucione sportive dhe ekonomike, në agjenci shtetërore, sipërmarrje private turistike etj. DMST-ja duhet të bëjë më shumë në drejtim të nënshkrimit të marrëveshjeve me IAL të huaja të cilat ofrojnë programe studimi të njëjta apo të ngjashme e cila do të mundësonte funksionimin e mobiliteteve sidomos për studentët dhe stafet akademike në të

	<i>ardhmen e afërt sidomos në këtë fazë ku është prioritet ndërkombëtarizimi i universiteteve shqiptare.</i> - Evidenca I.19 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UST - Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 60 - Evidenca I.21 Lista e mobiliteteve të Universitetit			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Ndonëse më pak se 7 vite aktivitet akademik në këtë program studimi, GVJ mësoi se çdo vit nga DMST-ja harton një raport vjetor të përfitimit prej marrëveshjeve në të cilin analizohen arritjet dhe përcaktohen objektivat, përfshirë këtu edhe ato në fushën e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Raporti vjetor përmbledh dhe analizon përfitimet e këtyre marrëveshjeve. GVJ konstaton se UST në funksion të realizimit të praktikave sportive ka disa marrëveshje bashkëpunimi me një sërë aktorësh dhe institucionesh. DMST, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë aktorë të menaxhimit turistik dhe operatorë të turizmit aktiv, sportive dhe të aventurës. Në gjykimin tonë ky numër marrëveshjesh me institucione, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave sportive, krijojnë kushtet dhe mundësitë që këto segmente shumë të rëndësishme të formimit profesional të realizohen me cilësi dhe rentabilitet. Gjithashtu institucioni dhe njësia përgjegjëse janë në kërkim të vazhdueshëm të bashkëpunëtorëve dhe partnerëve potencialë. - Evidenca I.16.2 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore të njësisë bazë DMST për vitin 2022-2023			
Konkluzione	GVJ konkludon që njësia kryesore dhe ajo bazë kanë siguruar marrëdhënie bashkëpunimi konkrete dhe dobiprurëse për studentët e këtij programi studimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion këto të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. Lidhja e marrëveshjeve edhe me IAL të huaja me programe të ngjashme do të mundësonte funksionimin e mobiliteteve sidomos për studentët ndonëse ky program është me 60 kredite ECTS dhe nuk disponon kohën e mjaftueshme për mobilitete afatmesme (semestrare).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” është program i nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është hartuar në përputhje me misionin e UST-së. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit në Sport dhe Turizëm, pranë FVFR në UST. Programi i studimit synon një formim sa më cilësor të studentëve në fushën e menaxhimit në sport dhe turizëm, bazuar në metodat dhe parime shkencore. Programi i ciklit të dytë të studimeve, master profesional, është i organizuar në lëndë/module sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ato realizohen në 1 vit studimi me 2 semestra, me 60 ECTS në total (30 ECTS për semestër). Konstatuam një lapsus në planin mësimor të dërguar në sistemin AMS përse i përket shpërndarjes së krediteve, ku plani i saktë është dërguar si dokument shtesë nga ana e departamentit përgjegjës për këtë program studimi dhe u verifikua. - <i>Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit, Neni 2; Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm</i> - <i>Evidenca I.5 Rregullore e programit të studimit, Neni 18, pika 2;</i> - <i>Evidenca II.2 Vendimi i Senatit për miratimin e formës së diplomës dhe suplementit të diplomës;</i> - <i>Evidenca II.2.1 Model diplome Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm; Evidenca II.2.2 Suplement i diplomës</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose	Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, synon të pajisë studentët me njohuritë bazë themelore të formimit profesional e shkencor në fushën e menaxhimit në sport dhe turizëm, përmes lëndëve të kategorive të ndryshme si të formimit të përgjithshëm, karakterizues, nderdisiplinore, njohuri të tjera formuese, teza etj.



punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Përmbajtja e programit, leksionet, literatura, veprimtaritë akademike e shkencore, mësimet praktike, synojnë formimin e studentëve me njohuritë bazë dhe metodat shkencore e aftësim praktik menaxherial. Jep njohuri bashkëkohore të fushës së menaxhimit në sport dhe turizëm aktiv, sportive dhe të aventurës. Veç kësaj nxit tek studentët të kuptuarit kritik të teorive shkencore të menaxhimit, si dhe parimeve akademike, duke i aftësuar me kompetenca të përparuara në këtë fushë studimi, në perballimin e zgjidhjen e problemeve teper komplekse të menaxhimit në përgjithësi dhe atij të turizmit në veçanti. Programi i studimit është në përputhje me direktivat edhe të Bashkimit Europian, në zbatim të kërkesave të AEHESIS, ku ka përcaktime specifike për univeristetet e sportit në Europë. Kështu, ka në përmbajtje blloqet e njohurive të fushës së sportit, të mjekësisë, të shkencave sociale e humane, të pedagogjisë e didaktikës, praktika mësimore që kushtezojnë formimin e shprehive të veçanta në një shumëllojshmëri profesioneve si në guida turistike, në menaxhim të sportit, trajnerë në lloje të ndryshme të sportit me moshat, drejtues i procesit mësimor të EF e sportit në shkolla, specialist i përgatitjes dhe fitnesit në palestra, etj., që japin mundësi pune sipas kërkesave të tregut të punës. <i>- Evidenca I.5 Rregullore programit të studimit, Neni 3</i> <i>- Evidenca II.1 Plan i mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm;</i> <i>- Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën mësimore në kredite të praktikës mësimore profesionale, si dhe detyrimet përmbyllëse. Në programin e studimit Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” praktika mësimore profesionale është pjesë përbërëse e planit mësimor të programit të studimit, vlerësohet me 10 kredite/195 orë dhe pasqyrohet si lëndë plotësuese në semestrin parë dhe të dytë. Është e përcaktuar dhe detyrimi përmbyllës me 5 ECTS, kategoria E, në përfundim të programit të studimit. Detyrimi përmbyllës është me provim të përgjithshëm përfundimtar. <i>- Evidenca Baza ligjore për elementët e programit të studimit,</i>



	<i>VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; VKM Nr. 879, Datë 18.12.2019; VKM Nr. 185, datë 25.03.2021;</i> <i>- Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm</i> <i>- I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 107; Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 70; Evidenca I.5 Rregullore e Programit të studimit, Neni 18, 19</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	N/A
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N/A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në	N/A




kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.				
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Në dijeninë tonë si GVJ, ky program studimi “Master profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm” është unikal dhe i vetmi program në llojin e vet në universitetet publike në Shqipëri i cili është formësuar si produkt i projektit ndërkombëtar Tempus – Speed me kooperimin dhe bashkëpunimin e një konsorciumi universitetesh nga Italia, Suedia, Greqia, Austria etj.			
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Bazuar kjo në shkresën 295 dt 16.01.2023 (Për afatet e kodifikimit të programeve të studimit, ofruar nga Institucionet e Arsimit të Lartë) dhe vendimi nr 310 dt 11.05.2022 (Për specifikimin dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë) e sjellë nga MAS konstatoam nga shqyrtimi i dokumentacionit se departamenti përgjegjës për këtë program studimi ka propozuar kodifikimin kombëtar të programit të studimit master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm dhe është në pritje të aprovimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. - <i>Evidenca I.11 Procedura për kodifikimin e programit të studimit</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Konstatojmë se DMST-ja përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në Turizëm në kuadër të proceseve të ndërkombëtarizimit të IAL-së në Republikën e Shqipërisë ka objektiv për të ardhmen hartimin e programeve të përbashkëta në bashkëpunim me institucione të arsimit të lartë, vendase dhe/ose të huaja. - <i>Evidenca I.18 Strategjia e UST për Ndërkombëtarizimin 2024-2028.</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton që Standardi II.1 pra që programi i studimit organizohet në përgjithësi në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi por përmbushet kryesisht vetëm për shkak të lapsusit në tabelën e programit të studimit. Njësisë bazë do ti lihet rekomandim që plani mësimor të paraqitet në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

18

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Konstatohet se mbështetur në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015 Kreu III Neni 23, DMST-ja si njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit i përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin pasi ushtron funksionin e tij në përputhje me përcaktimet e Nenit 23. Gjithashtu DMST-ja duke ju referuar ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015 Kreu III, Neni 25, konstatohet se i përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin pasi ushtron funksionin e tij në përputhje me përcaktimet e Nenit 25. Njësia kryesore FVFR përbëhet nga tre departamente, departamenti “Menaxhim të Sportit e Turizmit”, departamenti “Lëvizja dhe Shëndeti” dhe “Veprimtaria Fizike, Rekreacioni dhe Turizmi”. Njësia bazë, departamenti “Menaxhim në Sport e Turizëm” është përgjegjës për programin Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”. Ai përmbush detyrimet ligjore bazuar në Nenin 25 të Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë sepse ka në përbërje për vitin akademik 2024-2025 8 (tetë) anëtarë personal akademik efektiv nga të cilët 4 (katër) mbajnë gradën shkencore Dr., 1 (një) Docent dhe 3 (tre) janë me gradën shkencore Msc, si dhe 1 (një) personel ndihmës akademik me karakter mësimor me gradën shkencore Msc. Për vitin akademik 2023-2024, departamenti kishte në përbërje 8 (tetë) anëtarë personal akademik efektiv nga të cilët 1 (një) mban titullin Prof. Dr., 3 (katër) mbajnë gradën shkencore Dr. dhe 5 (tre) janë me gradën shkencore Msc, si dhe 1 (një) personel ndihmës akademik me karakter mësimor me gradën shkencore Msc. - <i>Evidenca II.5 Urdhër për hapjen e FVFR</i> - <i>Evidenca I.1 Statuti, Neni 10; Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 4; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Tabela 1</i> - <i>Evidenca I.4 Urdhri i hapjes së Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm</i> - <i>Evidenca II.6 Vendimi i akreditimit të Masterit Profesional në Menxhim në Sport dhe Turizëm</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e	GVJ, konstaton se Departamenti i Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit që ofron programin e studimit Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 i Arsimit të Lartë, Neni 25, pika 4, ka të angazhuar 1 (një)

përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	personel ndihmës akademik, i cili punon për realizimin e praktikave mësimore për realizimin e praktikave në terren, në përputhje me bazën ligjore në fuqi, duke përbushur kështu detyrimet e përcaktuara. Ky personel kryen veprimtari këshillimi për studentët dhe detyra administrative, zgjidh në kohë gjithë problematikat organizative e financiare për zhvillimin e orëve mësimore të lëndëve në mjediset, organizatat, klubet dhe bizneset jashtë UST-së, si dhe mundëson funksionimin optimal të klasave, auditoreve, laboratorëve të zhvillimit të lëndëve mësimore etj. - Evidenca I.15 Organigrama e Fakultetit; Evidenca II.7 Rregullore e punësimit, Kreu E; - ANEKS-TABELAT PËRBLEDHËSE, Tabelat 1 dhe 2			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Konstatojmë nga vizita dhe takimet në institucion që rolin e koordinatorit për programin e studimit Master Profesional në Turizëm e kryen apo realizon vetë përgjegjësi i njësies bazë DMST, i cili është autoriteti drejtues akademik i kësaj njësie bazë. Nga vizita në institucion dhe bisedat me stafin pedagogjik të këtij programi studimi konstatojmë që ka harmoni në ndarjen e zbatimit e detyrave. Koordinatori i programit të studimit, përcakton pedagogët përgjegjës (tutorët) sipas kurseve e grupeve, të cilët janë pedagogët që japin mësim pranë njësies bazë në një vit akademik. - Evidenca II.8 Rregullore e DMST, Neni 11; - Evidenca I.16.2 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore të njësies bazë DMST për vitin 2022-2023			
Konkluzione	GVJ konstaton që Standardi II.2 pra që njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit i përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi dhe për këtë arsye standardi përbushet plotësisht.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të	FVFR dhe Departamenti DMST, zotërojnë informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbytjen e programit të studimit Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”. Si

ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. Departamenti i Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit, pjesë e FVFR-së përgjegjëse për programin Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” disponon të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me organizimin, strukturën, si edhe përmbajtjen e programit të studimit. Anëtarët e personelit akademik kanë mundësinë të njihen me Statutin e UST-së, Rregulloren e studimit të UST-së me planin mësimor të programit të studimit si edhe syllabuset e lëndëve. - <i>Evidenca II.8 Rregullore e DMST</i> - <i>Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit</i> - <i>Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm</i> - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025</i> - <i>Evidenca II.2.1 Model diplome Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm</i> - <i>Evidenca II.2.2 Suplement i diplomës</i> - <i>Evidenca II.10 Struktura mësimore e programit të studimit 2024-2025</i> - <i>Evidenca I.10 CV e stafit akademik të angazhuar për programin e studimit; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Tabela 6</i> - <i>Evidenca II.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar MP në Menaxhim në Sport dhe Turizëm</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Ne si GVJ konstatojmë se Planin mësimor në programin e studimit Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” në UST ka të përcaktuara e të detajuara informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuntimin, ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Duke ju referuar Ligjit Nr. 80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 73, pikat 1, 2 si dhe aktet e tjera rezulton se programi i studimit Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” ofrohet në përputhje me përcaktimet ligjore pasi organizohet në lëndë, module, praktika e aktivitete formuese. - <i>Evidenca II.1 Planin mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm (Dokumenti shtesë)</i>

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Si GVJ, konstatohet se programi i studimit Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kriteret e përgjithshme të pranimit janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit dhe publikohen edhe në faqen zyrtare të universitetit ust.edu.al. Gjithashtu në Rregulloren e Studimeve Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” në UST përcaktohen qartë kriteret për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. - <i>Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 60, 73, 78; Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 67, 93, 94, 96</i> - <i>Evidenca II.12.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2022-2023;</i> - <i>Evidenca II.12.2 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2023-2024;</i> - <i>Evidenca II.12.3 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2024-2025</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Konstatohet se syllabuset e lëndëve të përfshira në programin e studimit “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” strukturohen sipas formatit që miratohet në nivel institucioni. Në fillim të semestrit përgjegjësi i departamentit miraton syllabuset të cilat janë hartuar sipas udhëzimeve specifike, dhe në to paraqiten përmbledhja dhe rezultatet e të nxënësve, konceptet themelore, temat për çdo javë të veprimtarisë mësimore (leksion, seminar, ushtrime), forma e kontrollit të dijes së si edhe literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar. <i>Konstatohet që është e nevojshme që pas këtij akreditimi disa nga syllabet të rishikohen në mënyrë që për çdo temë mësimore duhet vendosur në krah literaturë përkatëse sepse në disa syllabuse ajo është e vendosur vetëm formalisht.</i> - <i>Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm;</i> - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025</i> - <i>Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 55; Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit, Neni 17</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje dhe	Çdo vit akademik, Departamenti DMST, përgjegjës për programin, pedagogët titullarë të lëndëve, reflektojnë për përmirësimet në programin e studimit. Konstatohet që ndonëse vetëm 6 vite jetë si

përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	program studimi, stafi akademik ka formimin e nevojshëm për të bërë ndërhyrjet përmirësuese pas mbylljes së ciklit të disatë 1 vjeçar. Syllabuset paraqiten nga titullari i lëndës dhe pasqyrojnë çdo vit përmirësimin me njohuritë bashkëkohore dhe të metodave mësimore të përshtatëshme në funksion të cilësisë së përgatitjes së studentëve. <i>Gjykojmë që njësia kryesore dhe ajo bazë mundet ta konsiderojnë ristrukturimin e këtij masteri në master shkencor me 120 ECTS të shtrirë në dy vite akademike me 4 semestra.</i> - Evidenca II.3 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2022-2023; - Evidenca II.3.1 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2023-2024; - Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025			
Konkluzione	GVJ konstaton që Standardi II.3 pra që programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë dhe për këtë arsye standardi përmbushet plotësisht. Sugjerojmë që njësia kryesore dhe ajo bazë mundet ta konsiderojnë ristrukturimin e këtij masteri në master shkencor me 120 ECTS të shtrirë në dy vite akademike me 4 semestra			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015, Neni 73 thuhet: “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” thuhet se: Programet e ciklit të dytë të studimit, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 60 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1 deri dy vite akademike. Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Në përfundim të programeve të ciklit të dytë të

	studimeve lëshohet diploma “Master” në fushën e arsimit të kryer. GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konkludon se ngarkesa e programit të studimit është treguar në mënyrë të detajuar në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës së punës është bërë në përputhje me ECTS përkatëse dhe respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programi i studimit “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” për nga emërtimi, përmbajtja, mundëson pajisjen e studentëve me njohuri dhe kompetenca kyçe që i shërbejnë në ushtrimin e profesionit në të ardhmen. Shpërndarja e orëve praktike dhe teorike pasurojnë përvojën e të nxënit si dhe u mundëson studentëve aplikim të drejtpërdrejtë praktik të njohurive. Mësimi në auditor është në funksion të stimulimit të mendimit krijues/novator dhe kritik të studentëve, duke ndihmuar studentin në tregun e punës dhe punësimin e tij si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat ku sektori më potencial për punësim mbetet sektori i turizmit. - <i>Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm;</i> - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025;</i> - <i>Evidenca I.13 Informacion nga Sektori i Karrierës dhe Alumnit;</i> - <i>Evidenca II.13 Informacion nga Komisioni i Kurrikulës</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	GVJ konstaton se emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave realizohet mbështetur në VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021. Kategoritë mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A, B, C, D dhe E. Lëndët e ofruara janë ndërtuar me qëllim thellimin e mëtejshëm të njohurive të studentëve dhe rritjen e aftësive të tyre për t’u punësuar pas mbarimit të ciklit të dytë të studimeve si menaxherë të sportit dhe turizmit por dhe në fushat e guidave turistike. Konstatojmë që emërtimi i programit është në përputhje me fushën e studimit që mbulon programi. Në gjykimin tonë, informacioni dhe dijet që merr studenti janë njohuri specifike për sektorin e sportit dhe turizmit të domosdoshme për integrimin e tij në tregun e punës, duke e pajisur me aftësi dhe me formim të plotë për të ushtruar profesionin e specialistit në fushën e drejtimit dhe menaxhimit të sportit dhe turizmit, në subjekte private dhe publike brenda dhe jashtë Shqipërisë.

	- <i>Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm;</i> - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	GVJ konstaton se struktura e programit është ndërtuar në përputhje me Kartën e Bolonjës, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit master profesional. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e pasur të stafit, dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare që kur u krijua nga projekti ndërkombëtar Tempus - Speed. Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” në UST, parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse, në përputhje me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin e krediteve dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndët specifike, programi i saj paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Raporti teori praktikë, sidomos për lëndët menaxheriale që zhvillohen në subjekte publike apo biznese private, është i tillë që favorizon aftësimin praktik me shprehitë praktike të menaxhimit. Raporti i orëve është 2/2 (2 orë leksion dhe 2 orë seminar), duke i dhënë mundësi rritjes së aftësive të studentëve në ushtrimin dhe aplikimin e njohurive teorike të marra në përputhje me profilin e programit. - <i>Evidenca II.14 Fletëpalosje e Projektit Tempus</i> - <i>Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm;</i> - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ konstaton se natyra e lëndëve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në kredite siguron integritet të aspekteve teorike të informacionit që jep një lëndë dhe aplikimeve të mundshme praktike dhe mundësojnë arritjen e objektivave formuese. Statuti i UST-së ka material të plotë mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Proçeset dhe kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuara në dokumentat rregullatorë të institucionit dhe të programit të studimit, në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe

	nënligjore në fuqi. Studentët informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve ose të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre. Për realizimin e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës së tij janë shfrytëzuar eksperiencia ndërkombëtare duke rritur kështu mundësinë e transferimit dhe mobilitetit të studentëve si dhe mundësive për punësim pas përfundimit të studimeve. Zhvillimi i praktikës profesionale përgjatë një semestri synon që studenti të ketë aftësi për t'u përshtatur sa më shpejt në tregun e punës në përputhje me njohuritë e marra gjatë periudhës së studimeve si dhe zhvillimin drejt një karriere të suksesshme në profesionin që synon ky program studimi. - <i>Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit;</i> - <i>Evidenca II.15 Procedura e shpalljes së kandidatëve fitues Master Profesional</i> - <i>Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm;</i> - <i>Evidenca II.16 Informacion nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikut dhe Studentëve;</i> - <i>Evidenca II.16.1 Të dhëna statistikore nga Sektori i Alumnit për ecurinë e punësimit 2022-2024;</i> - <i>Evidenca II.13 Informacion nga Komisioni i Kurrikulës</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	GVJ konkludon se syllabuset e të gjitha lëndëve në këtë program studimi janë në përgjithësi në përputhje me përcaktimet të VKM 41, dhe 185 duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënës, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu. Gjatë shqyrtimit të syllabeve të programeve të lëndëve të programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” konstatojmë se një pjesë e mirë e tyre janë të përditësuara dhe janë të bazuara në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. <i>Sugjerojmë që syllabet pas këtij akreditimi të përditësohen me synime të qarta për përmirësimin e tyre në të ardhmen në favor të një mësimdhënie më cilësore. Mos të harrojmë se kemi autorë shqiptarë autoritete të padiskutueshme në fushën menazhimit të sportit dhe turizmit që kanë tekste universitare të shkëlqyera dhe me vlera të pakundërshtueshme.</i>

	- <i>Evidenca I.1 Statuti, Neni 63, pika 3, gërma b, c; Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit, Neni 17</i> - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të dytë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në vazhdim. Misioni i Departamentit të Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit në realizimin e programit të ciklit të dytë të studimit Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” është t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke u bazuar jo vetëm te kërkimi shkencor, por edhe tek njohuritë praktike dhe teknike, nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, aftësimit për përdorimin e arritjeve më të mira të shkencës, si dhe forcimit të partneriteteve me tregun e punës vendas e të huaj. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave profesionale. Si përfundim, synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe menaxheriale. - <i>Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm;</i> - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të dytë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në objektivat në vazhdim. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Lista e Profesioneve / Mundësive për punësim të studentëve që përfundojnë studimet në Programin Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” pranë UST-së janë: organizata



	jofitimprurëse me projekte nga fusha e sportit dhe turizmit, administratë qendrore dhe vendore, qendra rekreacioni, institute sporti, biznese e resorte me fokus turizmin aktiv, sportive dhe të aventurës etj.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton që Standardi II.4 pra që struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve si dhe kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe për këtë arsye standardi përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Po ti referohemi Statutit të UST, hartimi i Programit të Studimit përcaktohet si kompetencë e Departamentit të Menazhimit të Sportit dhe Turizmit dhe dërgohet për miratim në Senatin Akademik. Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” është në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe përmirësohet edhe nëpërmjet konsultave me institucionet homologe. Gjithashtu në FVFR realizohen pyetësorë me studentët nëpërmjet të cilëve sigurohet informacion mbi programin e studimit, si edhe është miratuar paketa e instrumenteve matës të cilësisë në UST në të cilën përmbahen pyetësorë që do të zhvillohen me studentë që do të diplomohen sivjet, me punëdhënësit etj. Bazuar në dokumentacionin e ofruar konstatohet se DMST-ja, për përmirësimin e përmbajtjes si programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, në bashkëpunim me zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit pranë UST-së, merr pjesë në trajnime, seminare informuese, ëorkshop-e të zhvilluara në bashkëpunim me kompani dhe biznese private dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, dhe për të marrë parasysh propozimet e tyre për përmirësimin e kurrikulës dhe për të asistuar studentët në karrierën

	e tyre. - <i>Evidenca I.2 Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës 2021-2026, Prioriteti Strategjik 2</i> - <i>Evidenca I.13 Informacion nga Sektori i Karrierës dhe Alumnit</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Po në Statutin e UST-së mbi të drejtat e studentit, përcaktohet edhe e drejta e studentëve për të shprehur vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit të UST. Në përmbushje të kësaj të drejte themelore si edhe në funksion të përmirësimit të programit të studimit, studentët janë të përfshirë në struktura të ndryshme si në: • Grupin e Vlerësimit të Brendshëm në Senatin Akademik; • Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FVFR; Gjithashtu, në paketën e miratuar të instrumentave matës të cilësisë në UST, në funksion të përmirësimit të programit të studimit mbi bazën e përgjigjeve të marra, përfshihen ndër të tjera edhe pyetësorë për studentët do do të diplomohen në UST edhe në këtë program studimi. - <i>Evidenca II.18 Lista e anëtarëve student në Senatin Akademik dhe në Komisionet e Senatit</i> - <i>Evidenca II.19 Vendimi i Konstituimit të Këshillit Studentor</i> - <i>Evidenca II.19.1 Rregullore e Këshillit Studentor</i> - <i>Evidenca II.13 Informacion nga Komisioni i Kurrikulës;</i> - <i>Evidenca II.16 Informacion nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikut dhe Studentëve;</i> - <i>Evidenca II.16.1 Të dhëna statistikore nga Sektori i Alumnit për ecurinë e punësimit 2022-2024</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Nëse i referohemi Strategjisë së Zhvillimit të programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, ky program studimi është organizuar në bazë të marrëveshjes së Kartës së Bolonjës dhe legjislacionit në fuqi. Kurrikula e programit të ofruar për nivelin Master është hartuar mbi bazën e literaturës shkencore dhe përvojave mësimore të Universitetit të Sporteve Tiranë, universiteteve homologe të Italisë, Athinës, Kroacisë, Sllovenisë, Austrisë etj. Zhvillimi i kurrikulës është një ndër prioritetet strategjike në Strategjinë e Zhvillimit të programit të studimit Master në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”. Në programin e studimit të ofruar, Departamenti DMST është përpjekur të përshtasë traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore, sportive, menazhuese dhe shkencore të vendit, si dhe të praktikojë modelet më të mira kurrikulare të vendeve fqinje dhe atyre të BE-së.

	- Evidenca I.19 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UST; - Evidenca I.16.2 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore të njësisë bazë DMST për vitin 2022-2023; - Evidenca II.16.1 Të dhëna statistikore nga Sektori i Alumnit për ecurinë e punësimit 2022-2024			
Konkluzione	GVJ konstaton që Standardi II.5 pra që institucioni i arsimit të lartë UST, ka mekanizmat dhe aftësinë për të nxitur përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit Master në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre dhe për këtë arsye standardi përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Ashtu sic theksohet në Statut, UST-ja ka për mision: të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit. Programet e studimeve hartohen në përputhje me vizionin dhe misionin e UST-së, të shprehura edhe në Strategjinë e zhvillimit të FVFR-së. Programi i studimit Master në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” është plotësisht në përputhje me vizionin dhe misionin e UST-së, si dhe me fushën e veprimtarisë së tij. Ky program synon zhvillimin e aftësive që do ta bëjnë të diplomuarin në këtë program studimi të aftë për t’ju përgjigjur nevojave në rritje të ekonomisë sidomos në fushën prioritare të turizmit i cili këto vitet e fundit është motorri kryesor i zhvillimit ekonomik dhe perspektiv të vendit. Gjykojmë që ky program studimi që po riakreditojmë, përcakton saktë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. - Evidenca I.1 Statuti, Neni 4, 5 - Evidenca I.2 Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës 2021-2026, Vizioni, Misioni - Evidenca I.3 Plani i zhvillimit të Fakultetit - Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit, Neni 3
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit në bashkëpunim të ngushtë me njësinë bazë DMST, nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore,

administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi mbështet, nxit dhe respekton stafin akademik në organizimin e veprimtarive të mësimdhënies, në punën e tyre kërkimore-shkencore, në pjesëmarrjen në studime dhe projekte të ndryshme në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas dhe të huaj, si dhe në shkëmbimin e eksperiencave dhe kualifikimit të tyre. - <i>Evidenca I.1 Statuti, Neni 7</i> - <i>Evidenca I.16.2 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore të njësisë bazë DMST për vitin 2022-2023</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Konstatohet se studentët e programit të studimit Master Profesional në "Menaxhim në Sport dhe Turizem", janë përkrahur, stimuluar dhe përfshirë në veprimtari dhe organizime të larmishme të udhëhequr nga pedagogët e tyre. Studentët janë ftuar që të përfshihen në projekte të insitucionit, si dhe aktivitetet e tjera në bashkëpunim me partnerët e UST-së. - <i>Evidenca II.20 E dhënë tabelore për projektet e financuara nga UST.</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Në FVFR, Njësitë bazë E zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me misionin dhe fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, si dhe në programet e zhvillimit në rang rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. UST-ja dhe strukturat e saj janë të angazhuara që të mbështesin aktivitetet kërkimore dhe studimore të njësive bazë, duke qenë se kërkimi dhe projektet kërkimore shkencore janë pjesë e objektivave prioritare që merren parasysh në hartimin e projekt buxhetit të institucionit. UST mundëson botimin e punimeve shkencore të stafit të tij akademik në revistën shkencore të UST-së (JPAS) si dhe u vë në dispozicion të kërkimit shkencor të gjitha paisjet dhe laboratorët që ajo disponon. Konstatohet që UST është bashkëorganizatore në disa konferenca ndërkombëtare në këto 4 vitet e fundit ku ka financuar stafin akademik që ka fituar të drejtën e prezantimit të punimeve shkencore. - <i>Evidenca I.7 Platforma Institucionale e Kërkimit Shkencor të UST; Evidenca II.21 Strategjia për kërkimin shkencor në UST 2020-2025</i> - <i>Evidenca II.22 Vendim i Bordit të Administrimit për Miratimin e Regjistrimit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike; Evidenca II.23 Vendime të Senatit Akademik për projektet e financuara nga UST</i>



	- Evidenca II.24 Vendimi i Senatit Akademik për revistën shkencore të UST			
Konkluzione	GVJ bazuar dhe mbështetur në dokumentacionin e bollshëm që na është vënë në dispozicion si nëpërmjet platformës AMS ashtu edhe gjatë vizitës në institucion konstaton dhe konfirmon që ky program studimi garanton orientimin e duhur në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor sepse vetë UST disponon një numër të konsiderueshëm laboratorësh, ka revistën e saj shkencore si dhe financon personelin e saj akademik për referime dhe botime kryesisht jashtë vendit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	UST, një nga shtyllat e veprimtarisë së saj ia ka dedikuar punës kërkimore shkencore. Shtylla e Kërkimit të Aplikuar dhe Inovacionit, ka në fokus organizimin dhe bashkëpunimin e njësive të angazhuara në veprimtaritë kërkimore me karakter shkencor dhe të aplikuar, inovacionin dhe projektet në fusha të ndryshme si aktiviteti fizik për shëndet, turizmi sportive dhe i aventurës, menaxhimi në sport dhe turizëm etj. Zv. Rektori për Kërkimin Shkencor, krijon lidhjen ndërmjet Departamenteve dhe strukturave të kërkimit të aplikuar dhe koordinon zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta si hartimin e strategjive, raportet, monitorimin dhe analizat, procedurat, vlerësimet etj., dhe aktivitete si Konferenca dhe Botime, Evente, Projekte dhe Programe, Partneritet Nderkombëtar dhe Promovim. Konstatojmë që stafi akademik i FVFR/DMST-së është i angazhuar në projekte kërkimore-shkencore, të financuara nga fondet e UST-së, AKKSHI ose Erasmus+, por njëkohësisht është i përfshirë dhe në projekte të tjera të fushës së sportit dhe turizmit në pozicionin e ekspertit ose konsulentit, në bashkëpunim me institucione dhe organizata të tjera. - Evidenca I.16.1 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore i FVFR për vitin 2022-2023; - Evidenca I.10 CV e stafit akademik të angazhuar për programin e studimit.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu	Departamenti i Menaxhimit në Sport dhe Turizëm DMST, bashkëpunon ngushtësisht me departamentet e tjeratë FVFR-së por




përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	edhe në rang UST-je dhe disa prej anëtarëve të këtij departamenti janë të angazhuar seriozisht në projekte kërkimore aplikative, etj. Kjo mundëson që personeli akademik të pasurojë eksperiencën e vet akademike, por edhe të ndihmojë studentët që të përfshihen në këto projekte. Pjestarë të stafit akademik i DMST-së janë të angazhuar edhe në pozicionin e ekspertit ose konsulentit, në bashkëpunim me institucione dhe organizata të tjera qeveritare dhe joqeveritare. - Evidenca I.16.1 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore i FVFR për vitin 2022-2023.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit si njësia kryesore në bashkëpunim permanent me DMST-në janë përfshirë sistematikisht në disa projekte kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe kanë një sërë marreveshje me IAL jashtë vendit në kuadër të programeve Erasmus+, që mundësojnë mobilitete të stafit akademik dhe studentëve të fakultetit. Gjithashtu, personeli akademik i FVFR-së ka qenë dhe mbetet i angazhuar në Konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare sidomos stafi akademik i cili po përmbush me sukses detyrimet e doktoraturës si në aspektin e referimeve ashtu edhe të botimeve në revista të indeksuara Web of Sciences apo Scopus ku një ndihmesë të madhe japin laboratorët e shumta të UST-së të cilat janë pasuruar me paisje e protokolle nga më bashkëkohoret falë projekteve të fituara në AKKSHI apo edhe brenda UST-së. <i>Sugjerojmë që brenda njësisë bazë DMST duhet të ketë më tepër avancime/kualifikime/botime nga ana e personelit akademik mbi menaxhimin në sport dhe turizëm në revista të indeksuara pse jo edhe me përfshirjen e studentëve të ekselencës.</i> - Evidenca I.21 Lista e mobiliteteve të Universitetit.
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Konstatohet që programi i studimit që po akreditojmë formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës sidomos në dy sektorë tejet të rëndësishëm me peshë kombëtare sic janë sporti dhe turizmi aktiv. Universiteti i Sporteve të Tiranës zhvillon dhe transmeton dije, si dhe përgatit specialistë të cilët kontribuojnë në zhvillimet lokale, rajonale apo kombëtare. UST-ja ka marrëveshje të shumta dhe sidomos në kuadër të ndërkombëtarizimit të universiteteve, bashkëpunon me homologë ndërkombëtarë dhe mundëson pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete ndërkombëtare. Studentëve të FVFR-së u është mundësuar përfshirja në mobilitete në kuadër të programit



	Erasmus+. Përsa i përket këtij programi studimi meqënëse është me kohëzgjatje 1 vit dhe me 60 ECTS <i>nuk kemi evidenca të pjesëmarrjes së studentëve në mobilitete, por besojmë se ristrukturimi i tij në të ardhmen me kohëzgjatje 2 vite dhe 120 ECTS do të krijonte mundësi të shumta në këtë drejtim.</i> - <i>Evidenca I.19 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UST;</i> - <i>Evidenca I.21 Lista e mobiliteteve të Universitetit.</i>			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	N / A			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	N / A			
Konkluzione	GVJ del në konkluzionin që programi i studimit Master në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor dhe njësia përgjegjëse DMST, mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore si dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkimin shkencor. Programi i studimit që po akreditojmë formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës sidomos në dy sektorë tejet të rëndësishëm me peshë kombëtare sic janë sporti dhe turizmi aktiv, sportive dhe i aventurës. Për arsyet e sipërpërmendura gjykojmë që edhe ky standart përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në programin e studimit, format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, ushtrime, mësim praktikë në terrene sportive e palestra, demonstrime konkrete dhe me teknologji, veprimtari outdoor, praktika/laboratore, detyrat e kursit, esse, punë individuale e prezantime, punë në grupe e prezantime, prezantime të rasteve të studiara nga praktika konkrete, praktikë profesionale, diploma. Këto janë të specifikuar në syllabuse dhe vlerësohen në lidhje me vlerësimin përfundimtar të studentit. Në të gjitha format synohet tu jepen studentëve njohuritë më bashkëkohore të lëndëve të programit, në mënyrë interaktive e tërheqëse, të orientuar nga aplikueshmëria e tyre në situatat konkrete. Studentët përdorin mendimin kritik, aftësim për përdorim kritik të materialeve të ndryshme burimore. Aftësimi për të qënë pjesëmarrës aktiv në diskutime nëpërmjet zotësisë për të analizuar, sintetizuar, krijuar, vlerësuar informacionin e tekstit mësimor apo të burimeve të tjera të jashtme si dhe të vëzhgimeve e kërkimeve të tyre. Format e mësimdhënies për këtë program studimi janë ato të miratuara nga institucioni, dhe përfshijnë: Leksione: 230 orë mësimore në auditor, Seminare: 200 orë mësimore në auditor, Laboratore: 30 orë mësimore në auditor, Praktika profesionale / stazh: 190 orë mësimore. Gjithsej 60 kredite / 650 orë mësimore. - <i>Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit;</i> - <i>Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm</i> - <i>II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në</i>

	Sport dhe Turizëm Konstatohet që personeli akademik u përgjigjet me përgjegjshmëri, diversitetit të studentëve ashtu edhe nevojave të tyre. Metodën e mësimdhënies të zbatuar nga pedagogët, janë harmonizuar që krahas zhvillimit të leksioneve në auditor si formë klasike e mësimdhënies gërshetuar me metoda bashkëkohore të aplikueshme, duke shfrytëzuar edhe platformat online. Gjithashtu përdoren edhe metoda të tjera si p.sh, konsultimet e vazhdueshme, plotësimi i kërkesave specifike gjatë vitit mësimor, sezonit të provimeve, organizimi i diskutimeve dhe debateve me studentët, trajtimi dhe zhvillimi i cikleve të leksioneve të hapura etj. Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit dhe duke pasur parasysh natyrën e programit të studimit dhe specifikën e çdo lënde të tij, mësimdhënia përfshin përveç metodave didaktike tradicionale, edhe metoda didaktike inovative, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie. - Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 80, gërma f - Evidenca I.5 Rregullore e Programit të studimit ; - Evidenca III.1.1 Udhëzues për mësimin në distancë për personelin akademik; -Evidenca III.1.2 Udhëzues për mësimin në distancë për studentët - Evidenca III.2 Vendim Senati për zhvillimin e mësimi online; - Evidenca III.3.1 Udhëzues për zhvillimin e orëve të laboratorëve, praktikumeve dhe praktikave profesionale në distancë; - Evidenca III.3.2 Udhëzues për politikën e vlerësimit në distancë; - Evidenca III.3.3 Udhëzues për përdorimin e platformës Teams për stafin akademik; - III.3.4 Udhëzues për përdorimin e platformës Teams për studentët; - Evidenca ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, - Tabela 17, Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.	UST, FVFR tregon një kujdes të veçantë në trajnimin e vazhdueshëm të personelit akademik për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Institucioni organizon trajnimin e pedagogëve sipas nevojave dhe nivelit të kualifikimit të secilit, në drejtime si: metodologjitë e mësimdhënies, teknologjitë në didaktikë, inovacionet në sektorë të ndryshëm, njohja e kuadrit rregullator




	të institucionit brenda kornizës së arsimit të lartë. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit të pedagogëve të angazhuar rishtazi, duke vënë theksin në aspektet metodike dhe të organizimit të procesit mësimor dhe më gjerë. Në keta aspekt pedagogët me përvojë, tituj akademikë bëjnë një punë konstante, të përjavëshme për të transmetuar përvojën e tyre në rritjen metodike e didaktike në realizim të kërkesave të programit mësimor. Format janë të larmishme si bisedat e diskutimet e vazhdueshme, orët e hapura, shrfytëzimi i literaturës bashkëkohore, etj. - <i>I.1 Statuti, Neni 7, pika 2</i> - <i>Evidencë I.1 Statuti, Neni 51, 58</i> - <i>Evidenca III.4 Financimi si partner në Konferenca ndërkombëtare</i> - <i>Evidenca I.18 Strategjia e UST për Ndërkombëtarizimin 2024-2028;</i> - <i>Evidenca I.20 Lista e projekteve të Universitetit; Evidenca I.21 Lista e mobiliteteve të Universitetit</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është me grada dhe tituj, aktiv në kërkimin shkencor, me eksperiencë në mësimdhënie, si dhe njohës të mirë të fushës së tyre respektive, tregues këta që mundësojnë kompetencën në shpjegimin e koncepteve, dhënien e njohurive dhe stimulimin e nxënies aktive. Në veçanti për lëndët e menaxhimit dhe sportit, pedagogët janë me karrierë të suksesshme duke mbuluar me kompetencë të lartë orët mësimore të lëndëve/moduleve që perbejnë programin mësimor. Metodat e përdorura për mësimdhënien janë të tipit të përzier me qasjet konstruktive në varësi të lëndëve dhe specifikave të lëndëve dhe vetë programit. Për të gjitha lëndët përdoret teknologjia dhe poëer point. Punohet seriozisht për aftësimin e studentëve për të përdorur njohuritë e fituara në situata konkrete të ndryshme, për të përdorur literaturë të ndryshme e të larmishme, përdorin mendimin kritik, përdorim kritik i materialeve të ndryshme burimore, të jenë pjesmarrës aktivë në diskutime me zotësinë për të analizuar, sintetizuar, krijuar, vlerësuar informacionin e tekstit mësimor apo të burimeve të tjera të jashtme si dhe të vëzhgimeve e kërkimeve të tyre. Në lëndët e programit të studimit është aplikuar zhvillimi interaktiv i leksioneve duke trajtuar çështjet kryesore të leksionit

	dhe duke tërhequr vëmendjen, mendimin e përvojën e studentëve dhe duke vendosur në qendër studentin, që leksioni të jetë sa më interaktiv dhe i kuptueshëm për ta. Mënyrat tradicionale të mësimdhënies gjatë kohës së studimit shoqërohen edhe me qasje të tjera konstruktiviste, si ushtrimet praktike, punimet e pavarura në grup ose individuale, studime rasti, problem solving etj. Pedagogët përdorin materiale audiovizuale, gjatë orës së mësimi për t'iu paraqitur studentëve situata reale. Aplikimi i formave dhe metodave të ndryshme të mësimdhënies kanë për qëllim inkurajimin e autonomisë, të nxëniti aktiv dhe me kreativitet tek studenti, studentët nxiten të bashkëpunojnë me njëri tjetrin. - <i>Evidenca I.10 CV e stafit akademik të angazhuar për programin e studimit</i> - <i>ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Tabela 4, Ngarkesa totale e personelit akademik të programit MP në Menaxhim në Sport dhe Turizëm në vitin akademik 2024-2025</i> - <i>Evidenca III.5. Pyetësor i Studentëve</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Departamenti i Menaxhimit në Sport dhe Turizëm vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces. Vlerësimi periodik i procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies realizohet me përfshirjen direkte të studentëve nëpërmjet instrumentave që njësia përdor. NJSBC-ja dhe njësia bazë mbledhin opinione dhe sugjerime lidhur me cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit, që vijnë nga vlerësimi i pedagogut dhe lëndës përmes pyetësorëve dhe kontakteve të vazhdueshme me ta. Rezultatet e monitorimit që pasqyrohen në raporte me gjetjet përkatëse vëne në lëvizje FVFR-në dhe DMST-në në marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të procesi mësimor në të ardhmen. - <i>Evidenca III.5 Pyetësor i Studentëve;</i> - <i>Evidenca III.6 Raport vjetor i NJSBC</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në	Me qëllim, përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, struktura e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në koordinim me FVFR-në dhe DMST-në zhvillon aktivitetin e vet të programuar për kontroll / vlerësimin me raportet me gjetjet përkatëse. Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e pedagogëve, për përmirësimin e njohurive të tyre mbi metodat e mësimdhënies përdorimit të metodave të

kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitet përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	reja etj. UST, FVFR, organizon trajnimin e pedagogëve sipas nevojave dhe nivelit të kualifikimit të secilit, në drejtime si: metodat e mësimdhënies, inovacionet në sektore të ndryshëm, njohja e kuadrit rregullator të institucionit brenda kornizës së arsimit të lartë. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit të pedagogëve të angazhuar rishtazi, duke vënë theksin në aspektet metodike dhe të organizimit të mësimin. - <i>Evidenca I.1 Statuti, Neni 31</i> - <i>Evidenca III.7 Rregullore e brendshme e Administratës;</i> - <i>III.1.1 Udhëzues për mësimin në distancë për personelin akademik</i> - <i>Evidenca II.24 Vendimi i Senatit Akademik për revistën shkencore të UST;</i> - <i>Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, neni 117, pika 14, 15, 16</i>			
Konkluzione	GVJ gjykon që UST-ja garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Personeli akademik i këtij programi studimi respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar formë, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në këtë program studimi është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të	Universiteti i Sporteve të Tiranës në zbatim edhe të ligjit dhe udhëzimeve të MAS ka hartuar dokumenta rregullatore që përcaktojnë kriteret dhe mënyrat e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe bëhen publike për studentët nga pedagogët dhe nga pedagogët e secilës lëndë/modul në fillim të çdo lënde.

studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Këto dokumenta janë: - Rregullorja e Studimeve në UST. - Rregullorja e FVFR. - Rregullorja e programit të studimit. Gjithashtu, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara edhe në syllabuset e lëndëve dhe pedagogët informojnë studentët në lidhje me to që në fillim të vitit akademik. - <i>Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 80, 81, 82</i> - <i>Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 81, 82, 83</i> - <i>Evidenca I.5 Rregullore e Programit të studimit, Neni 13</i> - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025</i> - <i>III.8 Rregullore e provimeve;</i> - <i>III.8.1 Mbi disa ndryshime në Rregulloren e Provimeve;</i> - <i>Evidenca III.9 Vendimi i Senatit për Korrigjimin Digjital të Provimeve me Sistemin Clean Score;</i> - <i>Evidenca III.9.1 Marrëveshje bashkëpunimi me AADF</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstaton se që në javën e parë të fillimit të çdo lënde/moduli, pedagogu informon studentët mbi programin lëndor, i cili përmban informacion mbi: • përmbajtjen e lëndës të organizuar në javë; • objektivat e lëndës; • rezultatet e të nxëniet të lëndës; • literaturën bazë dhe të rekomanduar; • materialet e tjera të lëndës; • metodën e vlerësimit të lëndës; • shpërndarjen e ngarkesës së bashku me afatet për secilin detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. Vlerësimi i lëndës përcaktohet apo është në varësi të tipologjisë së lëndës. Njoftime për provimet dhe vlerësimet vendosen edhe në platformën Pitagora. Kontakte të vazhdueshme me email me studentët mban edhe koordinatori i programit të studimit (Përgjegjësi i Njësisë Bazë). Përgjatë vizitës në institucion dhe gjatë intervistave me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi lehtësitë e marrjes së informacionit nga ana e studentëve. - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025</i>




Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Bazuar në syllabuset e lëndëve testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, që janë: • seminareve; • provimeve sezonale; • punimeve të temave të ndryshme shkencore; • ese; • projekte shkencore. Këto forma të larmishme u japin mundësi studentëve të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara sipas përcaktimeve të bëra në lidhje me sistemin e vlerësimit në Rregulloren e studimeve në FVFR si edhe në Rregulloren e programit të studimit. Për vetë specifikat, e lëndëve praktike sportive, përveç formave të sipërpërmendura përdoren edhe testimet praktike të aftësive sportive, demonstrimeve, aftësimit teknik e metodik sipas disiplinave përkatëse. - <i>Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 80;</i> - <i>Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 46, gërma e, f;</i> - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025.</i> - <i>Evidenca III.10 Model i unifikuar i tezës së provimeve</i> - <i>Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 99;</i> - <i>Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 47, 48;</i> - <i>Evidenca rregullore e provimeve;</i> - <i>I.5 Rregullore e Programit të studimit , Neni 21, 22;</i> - <i>III.8 Rregullore e provimeve, Neni 6, 7</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton që Standardi III.2 pra që institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre. Konstatohet që kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e programit të studimit e cila është publike dhe njihet nga studentët. Gjithashtu studentët janë të informuar nga titullari i lëndës/modulit me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve. Studenti ka mundësi të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në këtë program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i një lënde apo nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtme: - Provimi i ndërmjetëm - Niveli i diskutimit në seminare - Detyra e kursit (ese, prezantime, projekte) dy detyra praktike - Provimi përfundimtar. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa elementeve, në varësi të tipologjisë së lëndës. Shkalla e përvetësimit të dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 1 deri 10), me pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS nga shkronja A deri në F). Vlerësimi me notë është i detyrueshëm. Nota kaluese konsiderohen nga 5 e lart dhe shkronjat nga A deri F. Referuar syllabuseve të lëndëve/moduleve testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Vlerësimi i studentit, bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit Master "Menaxhim në Sport dhe Turizëm", është i përcaktuar të bëhet mbi bazën e vlerësimit të vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuara në programin e disiplinës/modulit dhe vlerësimi me provim. Në Rregulloren e Programit të Studimit janë të përcaktuara gjithashtu detyrimet që duhet të shlyejë studenti në programin e studimit për lëndët në të cilat studenti vlerësohet me provim. Studentët njihen me format e kontrollit të dijeve nga pedagogu i lëndës që në prezantimin e tyre të parë. Për secilën nga format e angazhimit dhe kontrollit të njohurive dhe aftësive të studentit në syllabusin e lëndës përcaktohet pjesa në përqindje ndaj totalit në vlerësimin përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar i studentit përbëhet nga: - Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit i cili përbën 30 % të vlerësimit përfundimtar; - Vlerësimi në provim i cili përbën 70 % të vlerësimit




	përfundimtar. Llogaritja e Vlerësimit përfundimtar bëhet sipas përcaktimeve në Rregulloren e Universitetit. - <i>Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 81, 82; Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 47, 48</i> - <i>Evidenca I.22 Rregullore e FVFR Neni 46, gërma e, f</i> - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025</i> - <i>Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 95, pika 1; Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 84, pika 2</i> - <i>Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit UST, Neni 81, 82, 103</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga vizita në institucion konstatojmë që, në përgjithësi, provimet janë në formatin e provimeve të bazuara në letër, zhvillohen dhe vlerësohen në mënyrë anonime. Detyrat, projektet, dorëzohen në mënyrë elektronike dhe/ose të printuar tek pedagogu përkatës. Studenti fiton të drejtën e dhënies së provimit të një lënde kur ka qenë i pranishëm në masën e detyrueshme në leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat sipas përcaktimeve edhe në Rregulloren për funksionimin e Sekretarisë Mësimore. GVJ konstaton që UST është pjesë e programit CleanScore të financuar nga AADF dhe sugjerojmë që ky program studimi duhet të kalojë drejt korigjimit 100% të testeve elektronikisht gjë e cila jep dy mundësi: -korigjimin në kohë rekord dhe pa kontestime. -ul në minimum subjektivizmin në vlerësimin e studentit me notë. Është shumë e rëndësishme në këtë proces që stafi akademik të trajnohet për mënyrën e hartimit të pyetjeve, nivelit të vështirësisë së tyre etj. - <i>Evidenca III.9 Vendimi i Senatit për Korigjimin Digjital të Provimeve me Sistemin Clean Score; Evidenca III.9.1 Marrëveshje bashkëpunimi me AADF</i> - <i>Evidenca III.3.2 Udhëzues për politikën e vlerësimit në distancë;</i> - <i>Evidenca III.3.3 Udhëzues për përdorimin e platformës Teams për stafin akademik</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Konstatojmë se vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Titullari i lëndës përfshin në testim çështje kryesore të trajtuara në leksione dhe seminare, por është shumë e rëndësishme që pyetjet e tezës

	mos të lidhen vetëm me leksionet, por edhe me literaturën bazë dhe të rekomanduar të cilat janë pjesë integrale e formimit dhe kontrollit të dijes së studentëve gjatë të gjithë vitit akademik. - <i>Evidenca I.5 Rregullore e Programit të studimit, Neni 13</i> - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025</i> - <i>Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 95, pika 1;</i> - <i>Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 84, pika 2</i> - <i>Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 103</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i kompetencave dhe aftësive të studentit, përveç vlerësimit me pikë/notë, shoqërohet me komente, veçanërisht në detyra kursi, projekte, prezantime dhe forma të tjera të ngjashme vlerësimi ku evidentohen pikat e forta dhe të dobëta dhe jepen rekomandimet përkatëse sesi ato mundet të përmirësohen. Gjatë takimit që patëm me studentët e programit u vu re perceptimi pozitiv nga ana e tyre mbi komentet, këshillat dhe rekomandimet e pedagogëve si mundësi konkrete që ndihmojnë studentët të përmirësohen në të ardhmen. Pedagogu në tezën e provimit ka edhe seksionin e komenteve për pyetjet me alternativa. Për zhvillimin e testit përfundimtar zhvillohet paraprakisht një seancë sqaruese me studentët, bëhet përmbledhje e temave dhe koncepteve kryesore të trajtuara dhe bëhet shpjegimi i kriterëve të vlerësimit. Pas takimit sqarues me studentët, pedagogu plotëson notat. Njohja me rezultatet paraprake të provimit u bëhet me dije studentëve nëpërmjet publikimit online në librezën e tyre elektronike (në sistemin Pitagora) ose pranë Sekretarisë brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e zhvillimit të tij. Pas shpalljes së rezultateve, studentëve u jepet e drejta brenda 2 (dy) ditëve pune të rishikojnë individualisht tezat e korrigjura prej pedagogut, duke parë në këtë mënyrë vlerësimin për secilën përgjigje të tyre (të shoqëruara me komente/feedback) dhe të paraqesin ankesat e tyre eventuale në lidhje me vlerësimin nga ana e pedagogut. - <i>Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 104</i> - <i>Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 90, pika 2</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë	UST, nëpërmjet rregullores mbi disiplinën e studentëve, merr të gjitha masat që sallat e provimeve të jenë të monitoruara, pa praninë e celularëve dhe të librave apo evidencave studentore në

plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	tavolinën e provimit si dhe dënon kopjen dhe plagjiaturën. Rastet e dyshuara për kopje ose plagjiaturë trajtohen përmes Këshillit të Etikës. Përveç rregullores së shkruar, universiteti përdor mekanizma që kontrollojnë plagjiaturën për detyrat me shkrim e sidomos temat e diplomave si detyrime përmbyllëse. Plagjiatura dhe kopjimi ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese gjatë vitit. Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte është e qartë se për të siguruar zhvillimin korrekt të provimit lëndës/modulit provimi mbikqyret nga anëtarët e komisionit. Gjithashtu masat për studentët që konstatohen duke kopjuar, janë parashikuar në Rregulloren e Studimeve në UST si edhe në Rregulloren e Programit të Studimit Master "Menaxhim në Sport dhe Turizëm" ku theksohet se studenti që kapet duke kopjuar gjatë provimit, ndërpret provimin, e vlerësohet mbetës në atë lëndë. <i>Sugjerojmë që UST në vazhdim të implementojë sistemin antiplagjiaturë (Turnitin Ephorus), i cili mundëson kontrollin dhe vlerësimin e pastërtisë dhe origjinalitetit të çdo punimi përpara vlerësimit përfundimtar. Kjo gjë do të vlente si për studentët por edhe më shumë për stafet akademike.</i> - Evidenca 1.6 Rregullore e Universitetit, Neni 111 - Evidenca III.11 Rregullore e Këshillit të Etikës të Universitetit të Sporteve të Tiranës, Neni 8
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ konstaton se në dokumentacionin dhe evidencat e shqyrtuara afatet e përfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura në kalendarin akademik të UST. Tezat e provimit formulohen nga titullari i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i lëndës përpara shumëfishimit për provim. Finalizimi i notave realizohet me anë të sistemit elektronik, pas periudhës së provimit përfundimtar. Vlerësimi i studentit bëhet në bazë të meritës. Dosja e provimit është e plotë në përmbajtje, duke përfshirë fletët e provimit, fletë-përgjigje, një kopje të pikëve të provimit përfundimtar dhe dy kopje të notave përfundimtare. Provimi i lëndës zhvillohet me sekretim. Sekretimi kryhet nga specialistja e departamentit ose nga sekretaria mësimore. Sekretimi bëhet në prani të komisionit të provimit Rezultatet jepen në kohë sipas përcaktimeve në aktet rregullatore



	te UST, FVFR dhe DMST. - <i>Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 84, pika 2</i> - <i>Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 97</i> - <i>Evidenca III.8 Rregullore e provimeve, Neni 10;</i> - <i>Evidenca III.9 Vendimi i Senatit për Korrigjimin Digjital të Provimeve me Sistemin Clean Score</i> - <i>Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 104</i> - <i>Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 90</i> - <i>Evidenca III.8 Rregullore e provimeve, Neni 15, 16</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit si dhe nga vizita në universitet u konstatua se studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u njohur me vlerësimin si dhe për të kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi duke paraqitur një ankesë në sekretarinë mësimore me anë të një formulari të veçantë, menjëherë pas shpalljes së notave përfundimtare, por para shënimit të notës në regjistrin e arritjeve akademike. Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të provimit, nëse studenti nuk është dakord me vlerësimin, ka të drejtë të bëjë ankesë me shkrim në department, i cili përcillet në dekanat me ngritjen e komisionit deri në sqarimin e studentit. - <i>Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 90, pika 2</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Pas shqyrtimit të rregulloreve dhe komunikimit me studentët gjatë programit të vizitave në institucion GVJ konstaton se studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e marrë dhe të marrë përgjigje sipas rregullave të përcaktuara. Në rastet kur pedagogu refuzon ndryshimin pas ankimimit të studentit, studenti bën një ankimim dhe ankesa i drejtohet përgjegjësit të departamentit i cili ngre një komision prej 3 vetësh për shqyrtimin e ankesës. Pedagogu i modulit/ lëndës, duhet t'i sigurojë të gjitha dëshmitë për vlerësimin e studentit (testin, punimet etj). Vendimi i Komisionit është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar dhe dokumentacioni bashkë me rezultatin dorëzohet në sekretarinë mësimore. I gjithë procesi realizohet në zbatim të rregulloreve të FVFR dhe departamentit të MST. - <i>Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit</i> - <i>Evidenca I.22 Rregullore e FVFR</i> - <i>Evidenca III.8 Rregullore e provimeve</i>
Konkluzione	GVJ për Standardin III.3 gjykon që UST siguron një vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Përdorimi i sistemit Clean

	Score në korigjimin elektronik të provimeve jep dy mundësi: - korigjimin në kohë rekord dhe pa kontestime si dhe - ul në minimum subjektivizmin në vlerësimin e studentit me notë. I gjithë procesi realizohet në zbatim të rregulloreve të FVFR dhe departamentit të MST ndaj ky standard në gjykimin tonë përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” synon ta pajisë studentin me: • Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit; • Aftësi drejt një profesioni apo diplome profesionale; • Formim qytetar të përgjithshëm; • Aftësi bazë për punë kërkimore; • Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; • Aftësim për promovim personal. Ky program jep një sistem të gjerë njohurish në fushën e menaxhimit dhe marketingut të sportit dhe turizmit, aspekteve ligjore të organizimit të sportit dhe turizmit, aspekteve psiko-sociale të menaxhimit të sportit dhe turizmit, etj. - <i>Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm;</i> - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit, për vetën llojin e tij si MP, thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në fushën e menaxhimit në sport dhe turizëm. Disa nga temat merren me fushat e menaxhimit sportiv si dhe të menaxhimit të turizmit aktiv, sportive dhe të aventurës në sektorin publik apo privat. Edhe aftësitë e tjera në fushat humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit preken nga lëndët e programit, për aq sa i nevojitet profesionit për të cilin përgatiten studentët. - <i>Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm;</i> - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të</i>

	<i>Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Pedagogët përpara përfundimit të lëndës bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Eseja, apo detyra e kursit që zhvillohet përpara përfundimit të lëndës është një formë e shqyrtimit të aftësisë së studentëve për të kuptuar çfarë ata kanë përfituar nga lënda. Pedagogu i lëndës i orienton studentët për provimin final, në lidhje me çështjet kryesore që duhet të kenë parasysh, apo sipas nevojës dhe kërkesës së studentëve ofrohen edhe konsultime për diskutimin e çështjeve/temave të paqarta përpara zhvillimit të testimit final. - <i>Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm;</i> - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia në UST synon të gërshetojë njohuritë teorike me aftësitë praktike, përmes ushtrimeve dhe detyrave ku studentët mund të zbatojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e marra. Ndaj në secilën lëndë të programit është parashikuar të zhvillohet një detyrë kursi, e cila ka 10% të vlerësimit përfundimtar. Gjithashtu, lëndë të caktuara të programit Master Profesional "Menaxhim në Sport dhe Turizëm" zhvillohen në laboratorët e UST-së ku studentët e këtij masteri anën teorike të leksioneve të marra e zbatojnë praktikisht. Praktika profesionale është një tjetër detyrim akademik i programit të studimit, e cila kryhet në pozicione pune sa më pranë fushës së studimit të programit, me synim rritjen e aftësive profesionale dhe integrimin më të mirë në tregun e punës. Studentët kanë në dispozicion bibliotekën digjitale në UST dhe Bibliotekën fizike me një fond të pasur librash, të cilat ndihmojnë studentin për të zhvilluar njohuritë, për t'u aftësuar në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve. Ky fond ndihmon studentin për studime të përparuara kërkimore-shkencore. - <i>Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm;</i> - <i>Evidenca II.3.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të Studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm 2024-2025</i>




	- Evidenca III.12 Fondi i Bibliotekës së UST; - Evidenca III.12.1 Rregullore e Bibliotekës së UST; - Evidenca III.12.2 Manual i U-Library - Evidenca I.21 Lista e mobiliteteve të UST; - III.4 Financimi si partner në Konferenca ndërkombëtare; - Evidenca I.13 Informacion nga Sektori i Karrierës dhe Alumnit.
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të menaxhimit në sport dhe turizëm jashtë strukturës së programit të studimit apo pjesë të forumeve e çorkshopeve të ndryshëm, ku studentët kanë mundësinë e zgjerimit të dijeve dhe prezantimit me risi të reja në fushën ku ata studiojnë. UST ka disa marrëveshje bashkëpunimi me kompani apo biznese prestigjioze, të cilat bëjnë të mundur angazhimin e personelit të tyre në trajnime të zhvilluara përmes leksioneve të hapura dhe orëve laboratorike. Në kuadër të seminareve jashtë strukturës së rregullt të programit, studentët e Masterit Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” kanë marrë pjesë në një vizitë studimore në “No Limits Academy”, ku u prezantuan me mënyrën se si përdoren teknologjitë digjitale për menaxhimin e trajnimeve, orareve dhe marrëdhënieve me klientët. Po ashtu, një tjetër sesion u zhvillua në “Nobis Wellness Center”, ku studentët ndoqën një orë të hapur mbi menaxhimin e qendrave të integruara të mirëqenies, si dhe u prezantuan me sisteme të avancuara të rezervimeve dhe analizës së të dhënave për përmirësimin e shërbimit ndaj klientit. - Evidenca I.21 Lista e mobiliteteve të Universitetit
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni UST suporton studentët dhe promovon programe e mbështet projekte për zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore duke i mbështetur financiarisht studentët me anë të çmimeve që ofrohen. Sektori i Karrierës dhe Alumnit informon vazhdimisht studentët e interesuar për pjesëmarrje në konkurse, aplikime për fitimin e bursave të studimit, shkolla verore/dimërore, a programe Erasmus+; njoftime këto që dalin edhe në faqen zyrtare të UST. - Evidenca I.2 Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës 2021-2026; - III.4 Financimi si partner në Konferenca ndërkombëtare - Evidenca I.13 Informacion nga Sektori i Karrierës dhe Alumnit; https://ust.edu.al/erasmus-2/

Konkluzione	GVJ konstaton që Standardi III.4 pra që institucioni garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët. Programi i studimit garanton thellimin e njohurive, për zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve edhe në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. Personeli akademik i vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe i orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. Për të gjitha argumentat e sipërpërmendura ky standard përmbyllet plotësisht.			
Shkalla e përmbyljes së standardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Duke iu referuar dokumentit I.22 për punimin e diplomës, jepet në mënyrë të detajuar çdo procedurë që ndiqet nga aplikimi dhe miratimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar. GVJ konstaton se procedura për provimin final para diplomimit të studentëve është e hartuar qartë dhe e publikuar nga ku studentët mund ta aksesojnë lehtësisht. UST ka hartuar udhëzuesin e provës finale ku jepen udhëzime për procedurat e përgatitjes dhe realizimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar. Kjo paketë udhëzimesh përmban të gjitha elementet për procedurat e përgatitjes, të konsultimeve, të monitorimit, të vlerësimit të punës njëvjecare; përmban përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në realizimin e kësaj veprimtarie përmbyllëse të programit të studimit. Departamenti harton nje bateri pyetjesh me alternativa, për disa lëndë të programit të studimit për të cilat studentët përgatiten. Provimi zhvillohet me shkrim. Për të fituar diplomën Master Profesional "Menaxhim në Sport dhe Turizëm" studenti duhet të ketë marrë 60 kredite ECTS, dhe të marrë provën finale që realizohet me provim të përgjithshëm përfundimtar. - Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 70; - Evidenca I.5 Rregullore e Programit të studimit , Neni 19
Kriteri 2. Strukturat	Studentët e programit MP "Menaxhim në Sport dhe Turizëm", në




përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	përfundim të studimeve të tyre realizojnë provimin përfundimtar, në formën e rastit studimor kompleks, të lidhur me profilin përkatës të studimit. Departamenti kujdeset që studentët të pajisen me gjithë dokumentacionin udhëzues në lidhje me përmbushjen e këtij detyrimi konform përcaktimeve në rregullore. Studentët që i nënshtrohen provimit të përgjithshëm orientohen në lidhje me literaturën që duhet të shfletojnë, si edhe u zhvillohen në klasë raste studimore të ngjashme, me qëllim që të familjarizohen me këtë formë testimi. - <i>Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 70, pika 2;</i> - <i>Evidenca II.11 Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Për programin Master Profesional "Menaxhim në Sport dhe Turizëm", duke qënë se fokusi i programit është përvetësimi i aftësive praktike profesionale nga ana e studentit, edhe provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë pikërisht aftësitë e studentëve për të aplikuar në një rast studimor njohuritë e përfituara nga programi i studimit. Provimi i përgjithshëm përfundimtar është konceptuar si një rast studimor kompleks, i lidhur ngushtë me profilin studimor të studentit, ku atij do i duhet të aplikojë njohuritë kryesore të përfituara për t'i dhënë zgjidhje gjatë kohëzgjatjes së provimit në klasë. Teza e provimit të përgjithshëm përfundimtar hartohen nga anëtarët e komisionit me pyetjet e përzgjedhuara nga fondi i krijuar sipas programit të provimit të përgjithshëm përfundimtar, firmosen nga Përgjegjësi i Njesisë Bazë dhe miratohet nga Dekani. - <i>Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 70, pika 3, 4;</i> <i>Evidenca III.13 Praktikë e miratimit të komisionit të provimit të formimit</i> - <i>Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 70, pika 2;</i> - <i>Evidenca III.13 Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar</i> - <i>Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 70, pika 4</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës.	N/A

Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Konstatohet se UST ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme, si dhe staf ndihmës për të asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve të ndryshme. Institucioni mund të ndihmojë studentët, duke shpërndarë pyetësorët e tyre, tek studentët e tjerë në UST nëpërmjet koordinatorëve ose me anë të pajisjes me një vërtetim zyrtar i mundëson studentit mbledhjen e të dhënave edhe jashtë UST-së. - Evidenca III.14 Infrastruktura laboratorike në UST
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Komisioni i vlerësimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar përbëhet nga pedagogë ose specialistë të fushës. Ata duhet të jenë mundësisht me tituj dhe grada. Në përfundim të provimit studenti vlerësohet me notë e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar pasqyrohet në procesverbalin përkatës. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të provimit. Vlerësimi me notë, procedurat e dokumentimi janë të përcaktuara në aktet rregullatore të UST, FVFR. - Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 70, pika 5
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Referuar Rregullores mësimore të UST, në përmbyllje të studimeve, atëherë studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Krahas diplomës, listës së notave dhe suplementit të diplomës, studentit i vihet në dispozicion sipas kërkesës së tij i gjithë programi i ciklit të dytë Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm. - Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit, Neni 107; - Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, Neni 74; - Evidenca II.2.1 Model diplome Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm;

	- Evidenca II.2.2 Suplement i diplomës			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UST arkivon dokumentacionin e studentit pas diplomimit në zyrat e arkivës. Rast pas rasti, bazuar në kërkesat specifike të studentëve, lëshohen vërtetime për qëllime të ndryshme. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet në dosje personale për një periudhë pa afat informacionit dhe paisjen e me informacionin që institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas legjislacionit në fuqi. Këto të dhëna janë të regjistruara dhe të ruajtura pranë sekretarive mësimore përkatëse e cila përbën regjistrin themeltar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të dhënat bazë i dërgohen Qendrës së Shërbimeve Arsimore ndërsa për arkivim respektohen parashikimet ligjore të vendosura nga ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar". - Evidenca III.15 Rregullore e Sekretarisë Mësimore e Digjitale, Neni 4 - Evidenca I.1 Statuti, Neni 92, pika 7			
Konkluzione	GVJ e gjen Standardin III.5 të përmbushur plotësisht sepse gjykojmë që UST dhe FVFR ndjekin një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Master Profesional "Menaxhim në Sport dhe Turizëm" dhe e përgatitin atë me dokumentacionin e nevojshëm. Strukturat përgjegjëse të DMST-së dhe personeli akademik i asistojnë studentët, duke vënë në dispozicionin e tyre informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të	GVJ konstaton se në programin e studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm që ofrohet nga FVFR ku department përgjegjës është DMST-ja, ofrohen praktika profesionale përgjatë të dy semestrave gjë e cila krijon mundësinë e shtrirjes së praktikës gjatë gjithë vitit akademik.

përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	UST-ja për realizimin e praktikës profesionale, ka bashkëpunime të gjera me institucionet e Administratës Publike në nivel qendror dhe lokal, federatat sportive, dhe biznese private që operojnë në fushën e sportit dhe turizmit kryesisht aktiv, sportive dhe të aventurës, për të mundësuar realizimin e praktikës mësimore në përputhje edhe me objektivat dhe specifikat që ka programi i praktikës profesionale. - Evidenca I.19 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UST; - Evidenca III.16 Rregullore e Praktikës Mësimore
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Studenti i Programit të studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm, falë marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit të nënshkruara mes UST-së dhe institucioneve publike dhe private, asiston në mjediset e tyre dhe përdor asetet dhe infrastrukturën që vetë këto institucione zotërojnë, për të parë nga afër mënyrën e realizimit të punës, procedurat e ndryshme që ndjekin këto institucione në varësi edhe të specifikave. Shtrirja e praktikave mësimore përgjatë gjithë dy semestrave të vitit akademik, mundëson ndërthurjen e koncepteve teorike me qasje hands-on, çka garanton përfitimin më të mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale të menaxherëve të ardhshëm të sportit dhe turizmit. - Evidenca I.19 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UST; - Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	GVJ konstaton se studenti i programit të studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm, pas kryerjes me sukses të praktikës profesionale, bën mbrojtjen e saj para një komisioni prej dy pedagogësh dhe në përfundim studenti vlerësohet me notën përkatëse. Kur studenti vlerësohet me notë kaluese nga komisioni i praktikës profesionale, ai përfiton edhe kreditet përkatëse ECTS të domosdoshme për përmbylljen e masterit me marrjen e 60 krediteve ECTS. - Evidenca I.22 Rregullore e FVFR, neni 60; - Evidenca II.1 Plani mësimor Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm; Master Profesional në Turizëm; - Evidenca III.16 Rregullore e Praktikës Mësimore
Konkluzione	GVJ gjykon që në rastin e programit të studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm, UST ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës praktikës profesionale, praktikave dhe stazheve të cilat me të




	drejtë ky program studimi i ka shtrirë gjatë gjithë vitit akademik pra tek të dy semestrat. Numri i lartë por dhe cilësor i marrëveshjeve të bashkëpunimit të UST me partnerët publikë dhe privatë mundëson realizimin e praktikave profesionale që sigurojnë përfitime shumë të mira të njohurive dhe kompetencave profesionale. Për të gjitha këto arsye edhe ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve											
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ konstaton se Departamenti i Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit (DMST) përmbush kërkesat ligjore në fuqi sa i takon nivelit të kualifikimit akademik të personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe mbulimit përkatës sipas fushave mësimore të personelit në realizimin e planit mësimor të programit të studimit Master Profesioal në “Menaxhim Sporti dhe Turizëm”. Gjithashtu, të dhenat e Personelit akademik të angazhuar për programin e studimit, për V.A 2022-2023, 2023-2024 dhe 2024-2025 janë si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/grada</th><th colspan="2">2022 – 2023</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. As. Dr</td><td>2</td><td>-</td></tr></table>	Tituj/grada	2022 – 2023		PAE	PAK	Prof. Dr	1	-	Prof. As. Dr	2	-
Tituj/grada	2022 – 2023											
	PAE	PAK										
Prof. Dr	1	-										
Prof. As. Dr	2	-										

Dr/PhD	4	-
Msc	4	-
Në total	11	0

Tituj/grada	2023 – 2024	
	PAE	PAK
Prof. Dr	1	-
Prof. As. Dr	3	-
Dr/PhD	4	-
Msc	5	-
Në total	13	0

Tituj/grada	2024 – 2025	
	PAE	PAK
Prof. Dr	-	-
Prof. As. Dr	3	-
Dr/PhD	6	-
Msc	4	-
Në total	13	0

Tabela 6.1; 6.2; 6.3 - Cilësia e stafit mësimdhënës të programit të studimit

Tabela Nr. 7 - Cilësia e stafit mësimdhënës të programit të studimit

Evidenca I.10 - CV e stafit akademik të angazhuar për programin e studimit

Tabela. Nr. 12 - Plani mësimor i lidhur me programin e studimit




Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar me kohë të plotë në programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm mbulon ngarkesën e këtij programi studimi në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, LAL 80/2015 dhe VKM Nr.418/2017. Për vitin 2022-2023, PAE ka realizuar 100% të programit; Për vitin 2023-2024, PAE ka realizuar 100 % të programit; Për vitin 2024-2025, PAE ka realizuar 100 % të programit; <i>Tabela. Nr. 12.1 - Plani mësimor i lidhur me personelin akademik</i> <i>Tabela. Nr. 12.2 - Plani mësimor i lidhur me personelin akademik</i> <i>Tabela. Nr. 12.3 - Plani mësimor i lidhur me personelin akademik</i> <i>Tabela. Nr. 13 – Ngarkesa totale në auditor për format e mësimdhënies për programin studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar me kohë të plotë për programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm disponojnë kontrata pune në përputhje me Kodin e Punës, duke përfshirë të gjitha kërkesat kontraktuale si aspektet financiare, sigurimet shoqërore dhe të gjitha komponentët e tjera të kontratës. Ndër vite ka stafi nuk ka pasur ndryshime thelbësore. <i>Evidenca Nr. IV.1 – Listpagesa sigurimet shoqërore/shëndetësore të personelit akademik;</i> <i>Evidenca Nr. IV.2 – Model kontrate punësimi me kohë të plotë</i> <i>Evidenca Nr. IV.2 – Model kontrate punësimi me kohë të pjesshme</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që	GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion se procedurat e rekrutimit të personelit akademik të punësuar pranë Universitetin e Sporteve të Tiranës janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi si dhe akteve rregulatore të IAL.



garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Universiteti i Sporteve të Tiranës garanton një iter procedural sa i takon punësimit të personelit akademik sipas një procesi transparent, që nga kërkesa e DMST sipas nevojave specifike, miratimi i Dekanatit, miratimi në Rektorat dhe shpallja në Buletinin e Prokurimeve Publike si dhe në faqen zyrtare të UST. <i>Evidence I.1 – Statuti (Neni 56)</i> <i>Evidence I.6 – Rregullore e Universitetit (Neni 53)</i> <i>Evidenca II.7 – Rregullore e punësimit (Kreu IV, PIKA 5)</i> <i>Evidence I.6 – Rregullore e Universitetit (Neni 8)</i> <i>Evidence IV.3; IV.3.1. – Procedure rekrutimi pedagog me kohë të plotë/të pjesshme</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni i programit të studimit, por dhe gjatë vizitës në institucion, se DMST ka si pjesë përbërëse 1 (një) personel ndihmës akademik me karakter mësimor (Znj. Brisilda Kalaja) për realizimin e orëve laboratorike, mirëmbajtjes së pajisjeve dhe mjediseve mësimore. <i>Evidenca II.8 – Rregullore e DMST (neni 15)</i> <i>Evidenca I.15 – Organigrama e Fakultetit</i> <i>Evidenca II.8 – Rregullore e DMST (neni 15)</i> <i>Evidenca I.10 - CV e stafit akademik të angazhuar për programin e studimit</i> <i>Tabela 6.1; 6.2; 6.3 - Cilësia e stafit mësimdhënës të programit të studimit</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe	GVJ konstatoi se Universiteti i Sporteve të Tiranës, bazuar në Statutin e saj administron të dhënat përmes Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Zyrës së Arkiv-protokollit, të cilat janë strukturat përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e dosjeve të personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe akteve të brendshme rregullative. Dosja përmban listën e dokumentacionit në përputhje me LAL dhe Rregullores s Brendshme të UST. <i>Evidence I.1 – Statuti (Neni 31, 64)</i> <i>Evidence V.4 – Rregullore e Brendshme e Administratës (Neni 7)</i>

administrativ.	<i>Evidence IV.4 – Model dosje personeli</i> <i>Evidenca I.6 – Rregullore e UST (Neni 40)</i> https://ust.edu.al/politikat-e-privatesise/
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	GVJ konstatoi se UST ka një numër të lartë marrëveshjesh me institucione, organizata dhe sipërmarrje brenda dhe jashtë vendit për realizimin e praktikës mësimore për programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim Sporti dhe Turizëm”, ku disa prej tyre: Univ. Romës “Foro Italico”; Universiteti Palermos/Veronas/Peruxhias; Univ. i Vienës; Aleanca Universitare Europiane; Observatori European i Sportit dhe Punësimit etj. Gjithashtu, departamenti DMST, ka të anagzhuar pedagogë të anagzhuar dhe të kualifikuar për ndjekjen e studentëve në kryerjen e punimit të diplomës si dhe praktikës profesionale. <i>Tabela Nr.5 – Institucionet dhe oraganizatat bashkëpunuese në rang programi për praktikat profesionale</i> <i>Tabela 6.1; 6.2; 6.3 - Cilësia e stafit mësimdhënës të programit të studimit</i> <i>Evidenca III.16 – Rregullore e Praktikës Mësimore</i> <i>Evidenca I.19 – Lista e marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	GVJ konstatoi se DMST disponon një sistem efikas informacioni për orientimin e studentëve gjatë gjithë ciklit të jetës së studentit, përmes trajnimit orientues në një proces periodik deri në fund të studimeve. DMST ka të angazhuar personel akademik të kualifikuar (Dr.proc. Holtion Orhani; Dr. Rando Kukeli) për ndjekjen dhe mbikqyrjen e praktikës profesionale të studentëve. <i>Tabela Nr. 4 – Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm</i> <i>Tabela Nr.5 – Institucionet dhe oraganizatat bashkëpunuese në rang programi për praktikat profesionale</i> <i>Evidenca III.16 – Rregullore e Praktikës Mësimore</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht pasi UST dhe DMST si njësi bazë përgjegjëse për programin ka të angazhuar

	<i>Personel akademik që përmbush standardet sasore dhe cilësore në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit Master Profesional në Mneaxhim Sporti dhe Turizëm. E gjithë ngarkesa mësimore mbulohet nga PAE.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
	GVJ konstatoi se UST disponon një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor por dhe jetës së studentit me kushtet e një kampusi: 3 Godina universitare ku njëra prej tyre 4 katëshe e rikonstruktuar me mjedise moderne, salla e koneferencave, laboratorë si dhe mjedise sportive të mbyllura dhe në natyrë. FVFR si njësi kryesore ka në funksion për realizimin e programit 2 auditore leksione, 4 klasa për seminare, 7 laboratorë për lëndët me të gjitha facilitetet fizike dhe teknologjike (rrjet lan, ëifi, projektorë) për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Gjithashtu ka dhe 1 labrotor të teknologjisë 46 m2 me rreth 40-50 poste të ulura me PC. UST plotëson të gjitha kushtet e normativës së VKM 418/2017, sa i takon hapësirës, systemin e ngrohjes qendrore (godina e rikonstruktuar), kondicionimit, kushtet higjeno sanitare, ndricimit natyral si dhe sistemin e mbrotjes kundra zjarrit. Veprimtaria mësimore e programit ushtrohet në Godinën 4 katëshe të Rikonstruktuar. <i>Tabela 16 – Mjediset e fakultetit/njësive bazë</i> <i>Evidenca IV.6 – Relacion mbi kapacitetet UST</i> <i>Evidence III.14 – Infrastuktura laboratorike</i> <i>Evidence IV.6.3 – Certifikatë për sigurinë nga zjarri</i> <i>Evidence IV.6.2 – Leja higjeno sanitare</i>

	Evidenca R.4.1 – Përmirësimet në infrastrukturë
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ konstatoi se UST disponon brenda kampusit mjedise mësimore me një infrastrukturë të përshtatshme teknologjike/dixhitale për zhvillimin e procesit mësimor teorik dhe praktik për mësimdhënie/mësimnxënie moderne sipas standardeve të përcaktuara. FVFR si njësi kryesore ka në funksion për realizimin e programit 2 auditore leksione, 4 klasa për seminare, 7 laboratorë për lëndët me të gjitha facilitetet fizike dhe teknologjike (rrjet lan, ëifi, projektorë) për mbarrëvajtjen e procesit mësimor. Gjithashtu ka dhe 1 labrotor të teknologjisë 46 m2 me rreth 40-50 poste të ulura me PC. Evidence III.14 – Infrastuktura laboratorike Evidenca R.4.1 – Përmirësimet në infrastrukturë
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ konstatoi se DMST në fukson të realizimit të procesit mësimor të programit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm disponon 1 (një laborator) të informatikës në Godinën Kryesore rreth 46 m2 e pajisur me rreth 40-50 poste të ulura me 26 PC të lidhura me rrjete lan, ëifi internet dhe videoprojektor. Tabela 16 – Mjediset e fakultetit/njësive bazë Evidence III.14 – Infrastuktura laboratorike Evidenca R.4.1 – Përmirësimet në infrastrukturë
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ konstatoi se UST ka në dispozicion 2 (dy) laboratorë të teknologjisë nga ku 1 (një) përdoret nga DMST në fukson të realizimit të procesit mësimor të programit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm. Laboratori ndodhet në Godinën Kryesore rreth 46 m2 e pajisur me rreth 40-50 poste të ulura me 26 PC të lidhura me rrjete lan, ëifi internet dhe videoprojektor. Tabela 16 – Mjediset e fakultetit/njësive bazë Evidenca R.4.1 – Përmirësimet në infrastrukturë
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të	GVJ konstaton se UST zotëron kapacitete infrastrukturore por gjithashtu dhe nga marrëveshjet e bashkëpunimit me organizata dhe shoqata ajo arrin të përmbushë me të gjitha kushtet realizimin e praktikës mësimore dhe profesionale të programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm.

posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	Evidenca I.19 – Lista e marrëveshjeve të Bashkëpunimit			
Konkluzione	GVJ konstaton se kriteret e këtij standardi përmbushen plotësisht, pasi UST ka siguruar mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm të përputhshme si për formimin teorik apo atë praktik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ konstatoi se studentëve të Programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm u vihet në dispozicion për garantimin e njohurive literaturë e detyrueshme dhe ndihmëse. Përveç teksteve dhe literaturës në <i>hard copy</i> , studentët mund të aksesojnë fondin fizik të bibliotekës (rreth 1102 tekste) si dhe kanë mundësi aksesit të barabartë dhe në burime online., të tilla si: U-Library dhe Koha që janë open source dhe pa limit. <i>Gjithashtu, GVJ sugjeroi që në literaturën e detyrueshme të moduleve/lëndëve përveç përmbledhjes së leksioneve të pedagogëve, të punohet për të përfshirë tekste mësimore të botuara në gjuhën shqipe. Nga raportimi i drejtuesve të departamentit dhe stafit, u informuam se janë në proces botimi 4 tekste nga titullarët e lënëve.</i>

	Evidenca II.3.2 – Programet lëndore (syllabuset) Evidenca III.12 – Fondi i bibliotekës
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ konstatoi se DMST ka një procedurë lidhur me përditësimin e literaturës përmes botimeve të fundit. Propozimet e njësive bazë miratohen sipas procedurave të UST. Pasurimi i fondit të bibliotekës ka një zë të vecantë në buxhetin vjetor të UST. Gjithastu, fondi i bibliotekës pasurohet dhe përmes donacioneve. Evidenca I.1 – Statuti, neni 36 Evidenca II.22 – Vendimi BA për miratimin e regjistrimit të prokurimeve publike/blerje librash Evidenca III.12 – Fondi bibliotekës Evidenca III.12.1 – Rregullore e bibliotekës Evidenca IV.7 – Formular dhurimi
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi se UST vë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik bibliotekën e cila disponon 1 (një) sallë me sipërfaqe 38 m² e cila disponon facilitetet e nevojshme si kompjuterë dhe mjete audiovizive. Biblioteka përmban librat, periodikët dhe materialet si në aspektin fizik (1102 tekste), por dhe online si U-Library dhe KOHA. Të gjithë studentët kanë akses te plote në përdorimin e bibliotekës në të gjitha ditët e javës përmes kartelës personale të përdoruesit që në momentin që regjistrohen në programin e studimit. Evidenca III.12 – Fondi bibliotekës Evidenca III.12.1 – Rregullore e bibliotekës Tabela Nr. 16 – Mjediset e fakultetit Evidenca III.12.2 – Manual përdorimi U-Library TabelaNr. 17 – Struktura e TI / Biblioteka online
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e	GVJ konstatoi se studentëve të Programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm u vihet në dispozicion për garantimin e njohurive literaturë e detyrueshme dhe ndihmëse. Përveç teksteve dhe literaturës në <i>hard copy</i>, studentët mund të aksesojnë fondin fizik të bibliotekës (rreth 1102 tekste) si dhe kanë mundësi akses të barabartë dhe në burime online të tilla si: U-Library dhe Koha që janë open source dhe pa limit.

të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Evidenca III.12 – Fondi bibliotekës Tabela Nr. 16 – Mjediset e fakultetit Evidenca III.12.2 – Manual përdorimi U-Library TabelaNr. 17 – Struktura e TI / Biblioteka online
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	GVJ konstatoi se UST garanton mundësi akasesimi për shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë për studentët e programit të studimit përmes përdorimit të platformës online U-Library në shërbim të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor për të aksesuar teskte dixhitale, peridiodike dhe punime shkencore/disertacione. Evidenca III.12.2 – Manual përdorimi U-Library https://ulibrary.rash.al/
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ konstatoi se biblioteka disponon 1 (një) sallë me siperfaqe 38 m2 e cila disponon facilitetet e nevojshme si kompjuterë dhe mjete audiovizive. Të gjithë studentët kanë akses te plote në përdorimin e bibliotekës në të gjitha ditët e javës përmes kartelës personale të përdoruesit që në momentin që rregjistrohen në programin e studimit. Evidenca III.12.1 – Rregullore e bibliotekës Tabela Nr. 16 – Mjediset e fakultetit
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ konstatoi se biblioteka është e aksesueshme nga e hëna në të premte (me përjashtim të festive zyrtare). Ajo garanton shërbime përmes punonjësve të bibliotekës sipas orarit të afishuar dhe ku të gjithë studentët kanë akses te plote në përdorimin e saj përmes kartelës personale të përdoruesit që në momentin që rregjistrohen në programin e studimit. Evidenca III.12.1 – Rregullore e bibliotekës Evidenca IV.8 – Kartela e studentit
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online	GVJ konstatoi se DMST ka një procedurë lidhur me përditësimin e literaturës përmes botimeve të fundit. Propozimet e njësisë bazë miratoren sipas procedurave të UST. Pasurimi i fondit të bibliotekës ka një zë të vecantë në buxhetin vjetor të UST. Gjithastu, fondi i bibliotekës pasurohet dhe përmes donacioneve. Evidenca II.22 – Vendimi BA për miratimin e regjistrimit të prokurimeve publike/blerje librash Evidenca III.12 – Fondi bibliotekës Evidenca IV.7 – Formular dhurimi

nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se kriteret e këtij standardi përmbushen plotësisht, pasi UST ka siguruar një bibliotekë dhe një sistem online që përmbush realizimin e procesit mësimdhënës/mësimnxënës të programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm.</i> <i>Gjithashtu, GVJ sugjeron që në literaturën e detyrueshme të moduleve/lëndëve përveç përmbledhjes së leksioneve të pedagogëve, të punohet për të përfshirë tekste mësimore të botuara në gjuhën shqipe.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstatoi se UST në përputhje me LAL 80/2015 si dhe aktet rregullative të saj administrojnë përmes sekretarisë mësimore regjistrat e të dhënave të studentëve (themeltar, arritjeve akademike dhe lëshimit të diplomave). Gjithashtu, si pjesë e RASH, disponon platformën PITAGORA si softëare me funksionalitete në shërbim të administratës, sekretarisë, stafit pedagogjik dhe studentëve sa i takon menaxhimit të strukturës akademike; pranimi/regjistrimi në provime; tarifave dhe busave; diplomave dhe suplementeve të tyre. <i>Evidenca III.15 – Rregullore e Sekretarisë mësimore</i> <i>Evidenca IV.9 – Manual përdormi Pitagora Pedagog</i>

	Evidenca IV.9.1 – Manual përdormi Pitagora Student
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ konstatoi se aktiviteti dhe dokumentacioni i personelit akademik, ndihmësakademik dhe adminsitrativ administrohet përmes Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nëpërmjet sektorit të Personelit dhe Statistikave dhe zyrës së Arkiv-Prorokollit ku adminsitrohen dhe përditësohen regjistrat, dosjet e personelit dhe librezat e punonjëve. Gjithashtu, bazuar në rregulloren e njësisë kryesore, DMST ruan dokumentacionin lidhur me personelin sa i takon ngarkesës, raporteve të realizimit të ngarkesës dhe programet lëndore të programit të studimit. Evidenca III.7 – Rregullore e brendshme e administatës Evidenca I.22 – Rregullore e FVFR (neni 5) Evidenca IV.5 – Model palnifikimi vjetor personeli akademik Evidenca IV.5.1 – Model realizimi vjetor personeli akademik
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi se UST adminsitron dhe siguron akses të dedikuar dhe konfindencial për personelin akademik dhe studentët përmes platformës PITAGORA https://ust.ptagora.rash.al/login si softëare me funksionalitete në shërbim të pedagogëve (informacione mbi lëndët, studentëve të regjistruar në sezona, procesverbale) dhe studentëve (informacion për statusin, lëndëve që frekuentojnë dhe rezultateve akademike). Informacionet mbi rregulloren e programit, misionin, qëllimin, strukturën dhe planin mësimor janë të akseueshme dhe në faqen ëeb të UST https://ust.edu.al/. Evidenca IV.9 – Manual përdormi Pitagora Pedagog Evidenca IV.9.1 – Manual përdormi Pitagora Student
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	GVJ konstatoi se UST garanton dhe forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit pedagog-student duke përdorur dhe platforma si Microsoft Teams dhe Office 365 duke mundësuar komunikim në distancë. Evidenca III.3.3 – Udhëzues për përdormin e platformës TEAMS për personelin akademik Evidenca III.3.4 – Udhëzues për përdormin e platformës TEAMS për studentët
Kriteri 5. Sistemi i	GVJ konstatoi se UST disponon paltformat elektronike si

menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Pitagora, Microsoft dhe Office 365, të cilat mundësojnë monitormin dhe raportimin e aktivitetit akademik dhe administrativ. Gjithashtu, DMST ruan dokumentacionin lidhur me personelin sa i takon ngarkesës, raporteve të realizimit të ngarkesës dhe programet lëndore të programit të studimit. Evidenca IV.5 – Model palnifikimi vjetor personeli akademik Evidenca IV.5.1 – Model realizimi vjetor personeli akademik			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstaton se faqja web përmban informacion në dy gjuhë shqip dhe anglisht. Gjithashtu, bazuar në Statutin e UST, njësia bazë DMST duhet të publikojë informacione që lidhen me programin e studimit (rregullore, plani mësimor, struktura mësimore, personeli akademik, kalendari i provimeve etj). <i>GVJ, sugjeron se hapësira e këtij programi studimi në faqen web duhet të pasurohet me më shumë të dhëna për studenët sa i takon informacioneve për këtë program.</i> <u>https://ust.edu.al/master-profesional-3/</u>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UST disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional të informacionit për veprimtarinë akademike dhe administrative në përmbushje të misionit të programit të studimit. GVJ, sugjeron se hapësira e këtij programi studimi në faqen eeb duhet të pasurohet me më shumë të dhëna për studenët sa i takon informacioneve për këtë program.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen	GVJ konstaton se UST harton raportin me mbështetjen financiare sipas nevojave për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Projekt buxheti hartohet nga administratori mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe bazë mbështetur dhe në planin strategjik të zhvillimit të UST, planin buxhetor afatmesëm dhe më pas



financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	miratohet nga BA me propozim të Senatit akademik. Pas miratimit buxheti kalon për menaxhim nga Drejtoria e Financës dhe delegohet në varësi të kërkesave apo nevojave të njësive për financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit të studimit; shpenzimet operative për mirëmbajtjen dhe facilitimin teknologjik të procesit mësimor; pasurimin e fondit të bibliotekës, projektet, grantet etj. <i>Evidenca IV.10 – Praktikë e përcjelljes së propozimeve të departamenteve për PBA</i> <i>Evidenca IV.10.1 – Miratimi i PBA nga SA dhe BA</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ konstaton se UST garanton planin e financimit për FVFR për realizimin e programit “Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm”. Pas miratimit buxheti kalon për menaxhim nga Drejtoria e Financës dhe delegohet në varësi të kërkesave apo nevojave të njësive për financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit të studimit; shpenzimet operative për mirëmbajtjen dhe facilitimin teknologjik të procesit mësimor; pasurimin e fondit të bibliotekës, projektet, grantet etj. <i>Evidenca II.22 – Vendim BA për miratimin e regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve publike</i> <i>Tabela Nr. 18 – Të ardhurat dhe financimet 2021-2023</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	GVJ konstaton se UST dokumenton gjendjen e financimit dhe aktivitetin e tij financiar, përmes Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit hartohet dhe paraqitet Raporti Financiar Vjetor. UST, në mënyrë periodike është subjekt i auditit financiar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe MAS. <i>Evidenca IV.11 – Raporti Financiar Vjetor 2023</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e	GVJ konstaton se Drejtoria e Financës dhe Buxhetit raporton për realizimin e buxhetit të miratuar për vitin paraardhës në Senatin

njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Akademik dhe Bordin e Administrimit. Raporti vjetor delegohet për informim të drejtuesve të njësive kryesore. Evidenca I.16 - Raporti Vjetor UST për V.A. 2022-2023			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	GVJ konstaton se UST garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit pasi burimet e financimit si institucion public garantojnë një pjesë nga buxheti i shtetit dhe një pjesë nga të ardhurat e siguruar nga tarifat e regjistrimit/studimit dhe të ardhura nga shërbime të tjera të ofruara nga institucioni. Gjithashtu, UST shqyrton përmes analizës financiare mirëmenaxhimin e fondeve në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë së tij financiare. Evidenca I.16 - Raporti Vjetor UST për V.A. 2022-2023 Evidenca IV.11 – Raporti Financiar Vjetor 2023 Tabela Nr. 18 – Të ardhurat dhe financimet 2021-2023			
Konkluzione	GVJ konstaton se Universiteti i Sporteve të Tiranës garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme dhe të qëndrueshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizmi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton	GVJ konstaton se UST zbaton politika dhe ka procedura që

dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	mbulojnë aktivitetin akademik të studentëve të programit në përputhje me LAL 80/2015 dhe akteve të brendshme rregullative. Procedura e pranimit është në përputhshmëri me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe udhëzimet e MAS. Kriteret dhe procedurat e pranimit parashikohen në Statut, Rregulloren e Universitetit, Kuotat e propozuara dhe miratuara të pranimit të studentëve dhe kriterëve të propozuara nga njësia bazë sipas legjislacionit në fuqi. Kriteret e pranimit, tarifat e regjistrimit për programin Master Profesional mund të aksesohen dhe në faqen eeb të UST https://ust.edu.al/master-profesional/ Evidenca I.1 – Statuti (Neni 13;20;34) Evidenca I.6 – Rregulore e Universitetit (Neni 20) Evidenca II.2.1; II.2.2, II.2.3 – Kuotat e propozuara dhe miratuara të pranimit të studentëve 2022-2025
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton se në UST garanton procedurat e pranimit sa i takon të drejtave dhe detyrimeve, të përcaktuara në Statut, Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Fakultetit, Rregulloren e Programit të Studimit, barazinë dhe të drejtat e studentëve që nga momenti pranimit dhe regjistrimit e deri në përfundimin e ciklit të studimit që përmbyllet me diplomimin. Evidenca I.1 – Statuti (Neni 75) Evidenca I.6 – Rregulore e Universitetit (Neni 59; 78;87;107) Evidenca I.22 – Rregulore e FVFR Evidenca I.5 – Rregulore e programit të Studimit (Kreu II, IV) https://ust.edu.al/ep-content/uploads/2025/01/vendim-senati-nr.-8.pdf https://ust.edu.al/ep-content/uploads/2023/12/Vendim-Senati-Nr.-140-dt.-19.12.2023-.pdf
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me	GVJ konstaton se UST harton dhe publikon kriteret e vecanta për përzgjedhjen e kandidatëve për tu pranuar në programet e studimeve. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve propozohen nga DMST në përgjigje të kërkesës së MAS, bazuar në kuotat e pranimeve një vit para fillimit të vitit akademik. Propozimet miratohen me vendim SA. Kuotat e pranimit për përogramin Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm




strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	parashikojnë dhe regjistrimin e studentëve nga trevat shqipfolëse. Evidenca II.2.1; II.2.2, II.2.3 – Kuotat e propozuara dhe miratuara të pranimit të studentëve 2022-2025 <u>https://ust.edu.al/ep-content/uploads/2025/01/vendim-senati-nr.-8.pdf</u>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ konstaton se në UST kriteret, procedurat e pranimit, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të parashikuara në Rregulloret e institucionit (Rregullorja e UST, FVFR, DMST). Informacionet janë të aksesueshme në faqen web http://ust.edu.al/ https://ust.edu.al/fakulteti-i-veprimtarise-fizike-dhe-rekreacionit/ https://ust.edu.al/akte-nenligjore/ , pranë sekretarisë mësimore FVFR dhe sistemit pitagora https://ust.pitagora.rash.al/login Evidenca I.6 – Rregulore e Universitetit (Neni 59; 78;87;107) Evidenca I.22 – Rregulore e FVFR Evidenca I.5 – Rregulore e programit të Studimit (Kreu II, IV)
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konstaton se UST përpara fillimit të vitit akademik informon kandidatët potencialë përmes faqes web/rreteve sociale/broshurave lidhur me kuotat, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta si dhe procedurat e pranimit të tyre në programin e studimit. <u>https://ust.edu.al/ep-content/uploads/2025/01/vendim-senati-nr.-8.pdf</u> <u>https://ust.edu.al/ep-content/uploads/2023/12/Vendim-Senati-Nr.-140-dt.-19.12.2023-.pdf</u> Evidenca I.3 – Informacion nga sektori I karrierës\ Evidenca V.1 – Paketa promovuese
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstaton se UST për programin Master Profesional në menaxhim Sporti dhe Turizëm parashikon kuota dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta 1 (një) kuotë, për kategorinë me statusin e jetimit 1 (një) kuotë, për komunitetin Rom dhe egjiptian 1 (një) kuotë. Evidenca II.2.1; II.2.2, II.2.3 – Kuotat e propozuara dhe miratuara të pranimit të studentëve 2022-2025



Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ konstaton se UST për programin Master Profesional në menaxhim Sporti dhe Turizëm parashikon kuota dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga trojet shqifolëse nga 1 (një) kuotë për shtete si Mali Zi, BiH, Maqedonia e Veriut, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë. <i>Evidenca II.2.1; II.2.2, II.2.3 – Kuotat e propozuara dhe miratuara të pranimit të studentëve 2022-2025</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ konstaton se UST ka procedura përkatëse për të implementuar bursa sociale për shtresat në nevojë dhe bursa ekselence për të rritur cilësinë e programeve të studimit. Sipas vendimeve të Bordit të Administrimit nr.11, 13, 16, 20, 30, 34, /2024 janë miratuar listat e studenteve të ciklit të parë dhe të dytë që përjashtohen 50% nga tarifat e shkollimit për shkak të trajtimit me ndihmë ekonomike, pasjes një prindi me aftësi të kufizuara (FVFR rreth 12 studente). <i>Evidenca II.4 – Vendimet e BA janar-gusht 2024 për bursat për kategoritë e vecanta.</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se UST harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura të barabarta dhe transparente për pranimin, përzgjedhjen, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin e studentëve në programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konstaton se UST ofron informacion të detajuar mbi kriteret dhe procedurat për përparimin akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Numri i krediteve të domosdoshme për kalimin nga një vit të tjetri si dhe humbja dhe përsëritja e vitit për shkak të mos plotësimit të saj, prashikohet në Rregulloren e FVFR; DMST dhe Programit të studimit. Studentët informohen nga pedagogët në çdo fillim viti akademik lidhur me

	syllabusin dhe detyrimet lëndore, sistemin e vlerësimit, format e kontrollit dhe vlerësimit të studentëve. <i>Evidenca I.22 – Rregulore e FVFR (neni 44)</i> <i>Evidenca II.8 – Rregulore e DMST (neni 20)</i> <i>Evidenca I.5 – Rregulore e programit të Studimit (neni 18)</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstaton se UST ka të parashikuar në mënyrë të detajuar procedurat e njohjes nga kualifikimet e mëparshme në një sërë aktesh (Statut, Rregullore e UST, Rregulore e FVFR dhe Rreguloren e Programit të studimit). Informacioni është i aksesueshëm pranë sekretarisë mësimore të FVFR por dhe në faqen web të institucionit https://ust.edu.al/rregulloret-2/ <i>Evidenca I.22 – Rregulore e FVFR (kreu IX)</i> <i>Evidenca I.6 – Rregulore e Universitetit (neni 78)</i> <i>Evidenca I.5 – Rregulore e programit të Studimit (neni 7-10)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstaton se studentët informohen nga pedagogët në cdo fillim viti akademik, por dhe gjatë vitit, lidhur me syllabusin dhe detyrimet lëndore, sistemin e vlerësimit, format e kontrollit dhe vlerësimit të studentëve. <i>Evidenca I.22 – Rregulore e FVFR (kreu VIII)</i> <i>Evidenca I.6 – Rregulore e Universitetit (neni 80-82)</i> <i>Evidenca I.5 – Rregulore e programit të Studimit (neni 13,14)</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se studentët e programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm diplomohen me provim të përgjithshëm formimi. DMST ka të parashikuar në rregulloren e programit procedurat e provimit të formimit. <i>Evidenca I.5 – Rregulore e programit të Studimit (neni 18-19)</i> <i>Evidenca II.11 – Program I provimit të përgjithshëm përfudnimitar</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura	Në fillim të çdo viti akademik institucioni organizon takime të hapura me të interesuarit dhe publikon udhëzues të posaçëm për informimin e studentëve që përfundojnë Ciklin I-rë për t'i informuar mbi programet e studimit të Ciklit II-të që ofron ky institucion. Gjithashtu UST është aktiv në rrjetet sociale, spoteve promovuese dhe faqen eeb lidhur me programet e studimit të

për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	ofruara prej tij. Evidenca I.3 – Informacion nga Sektori i karrierës dhe Alumnit Evidenca II.16 – Informacion nga Drejtoria e Marrëdhënieve me jashtë dhe studentëve Evidenca V.1 – Paketa promovuese			
Konkluzione	GVJ konstaton se UST ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm, informacionin e nevojshëm mbi vlerësimin e dijeve, njohjen dhe transferimin e krediteve deri në përfundim të ciklit të studimeve dhe diplomimit të studentëve. UST i kushton rëndësi edhe promovimit të programit të studimit tek të interesuarit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjatë takimeve në institucion, rezultoi se informimi i studentëve fillon që në takimet informuese që zhvillon DMST me studentët e vitit të parë të saporegjistruar lidhur me informimin mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, ndarjen në semestral, planit mësimor, krediteve të fituara, objektivat e programit, shfrytëzimit të bibliotekës, auditoreve si dhe Rregulores së programit të studimit. Informacione mbi programin e studimit janë të aksesueshme dhe në faqen web http://ust.edu.al/ Evidenca I.5 – Rregulore e programit të Studimit (neni 2)
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë	Gjatë takimeve në institucion, rezultoi se informimi i studentëve fillon që në takimet informuese që zhvillon DMST me studentët e vitit të parë lidhur me informimin mbi planin mësimor, krediteve të fituara, objektivat e programit sipas veprimtarive si dhe Rregulores së programit të studimit.

formuese.	Informacione mbi programin e studimit janë të aksesueshme dhe në faqen web http://ust.edu.al/ Evidenca I.5 – Rregulore e programit të Studimit			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ konstaton se UST ka politika orientuese për studentët në lidhje me tregun e punës. UST mer pjesë rregullisht në Panairin e Punës. Zyra e kurikulës dhe Alumni u shërben studentëve për krijimin e kontakteve dhe orientimit me tregun e punës. Numri total i të punësuarve 2022-2024 për programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm është 17 të punësuar në përputhje me diplomën nga 31 studentë të diplomuar. Evidenca V.2 – Aktivitete me tregun e punës Evidenca II.16 – Informacion nga Drejtoria e Marrdhënieve me Jastë dhe Studentët Evidenca II.16.1 – Të dhëna statistikore nga sektori alumni për ecurinë e punësimit			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstaton se studentëve u vihet në dispozicion informacioni lidhur me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambjentet e njësive kryesore, dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e institucionit lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	I gjithë informacioni lidhur me programin e studimit ë I aksesueshëm dhe në platformën pitagora. https://ust.edu.al https://ust.pitagora.rash.al/login			
Konkluzione	GVJ konstaton se informacioni i vënë në dispozicion për studentët është i plotë dhe lehtësisht i aksesueshëm lidhur me objektivat, strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm. I gjithë informacioni lidhur me programin e studimit ë I aksesueshëm dhe në platformën pitagora.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



				X
--	--	--	--	---

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Sekretaria mësimore e FVFR mban statistika vjetore mbi numrin e të diplomuarve për programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm të pasqyruara në regjistri themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në sekretarinë mësimore. Nr i studentëve të regjistruar sipas viteve: <table border="1"> <tr> <td>V.A. 2021-2022</td><td>21 studente</td></tr> <tr> <td>V.A. 2022-2023</td><td>13 studente</td></tr> <tr> <td>V.A. 2023-2024</td><td>20 studente</td></tr> </table> <i>Tabela Nr.21 – Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve</i> <i>Evidenca II.6.1 – Të dhëna statistikore nga Sektori Alumni për punësimin e studentëve</i> <i>Evidenca III.5. – Rregullore e sekretarisë mësimore e digjitale</i>	V.A. 2021-2022	21 studente	V.A. 2022-2023	13 studente	V.A. 2023-2024	20 studente
V.A. 2021-2022	21 studente						
V.A. 2022-2023	13 studente						
V.A. 2023-2024	20 studente						
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria mësimore e FVFR mban statistika vjetore mbi numrin e të diplomuarve për programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm. Në këtë program nuk ka patur c'regjistrime dhe transferime nga programe të tjera. <i>Tabela Nr.21 – Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve</i>						
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve	GVJ konstaton se sekretaria mësimore e fakultetit menaxhon të dhënat manualisht dhe në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemin						

duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	pitagora. Ruajtja e tyre garantohet në përputhje me aktyet ligjore në fuqi dhe mund të jenë të aksesueshme nga personat e autorizuar. <i>Evidenca III.5. – Rregullore e sekretarisë mësimore e digjitale</i> <i>Evidenca V.4 – Rregullore për mbrojtjen dhe përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se zotërohen dhe ruhen në mënyrë rigoroze të dhënat. Ato u shqyrtuan gjatë këtij procesi vlerësimi. Fakulteti i FVFR dhe departamenti DMST raporton realizimin e objektivave dhe veprimtarisë mësimore-kërkimore për cdo vit akademik. Sekretaria mësimore dhe institucioni raporton këto të dhënë edhe në raportin vjetor, që UST i dërgon Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ku përfshihet numri i përditësuar i studentëve të diplomuar. Regjistrat plotësohen në formë të shkruar dhe format elektronik duke ruajtur të dhënat në zbatim të udhëzimeve dhe legjislacionit në fuqi. <i>Evidenca V.5 – Realizimi i objektivave</i> <i>Evidenca I.16.1 – Raporti vjetor i Veprimtarisë së FVFR 2022-2023</i> <i>Evidenca I.16.2 - Raporti vjetor i Veprimtarisë së DMST 2022-2023</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ konstatoi se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, DMST, ka hartuar raporte analitike periodike lidhur me plotësimin e objektivave mësimore dhe kërkimore, ecuria e programeve të studimit, cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve, si dhe me objektivat për vitet pasuese akademike (si psh: nënshkrimi marrëveshjeve në fuksion të praktikës, organizimi ëorkshopeve për studentët, realizimi I projekteve etj.). Gjithashtu, Departamenti bashkëpunon dhe Zyrën e Alumnit lidhur me përditësimin e të dhënave statistikore të punsimit të studentëve që ndjekin programin MP në MST. <i>Evidenca I.16.2 - Raporti vjetor i Veprimtarisë së DMST 2022-2023</i> <i>Evidenca II.16.1. – Të dhëna statistikore nga sektori alumni mbi ecurinë e punësimit</i>
	<i>Tabela Nr.21 – Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve</i>

	Tabela Nr. 23 – Të dhëna për diplomimin dhe punësimin			
Konkluzione	GVJ konstaton se UST, mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhënat në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm. DMST ka hartuar raporte analitike periodike lidhur me plotësimin e objektivave mësimore dhe kërkimore, ecuria e programeve të studimit, cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve, si dhe me objektivat për vitet pasuese akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ konstaton se në UST studentët përfshihen dhe angazhohen me përfaqësinë e tyre në organet kolegjiale dhe vendimmarrëse të IAL, si: Senati Akademik (2 studentë) dhe në komisionet e tij si Komisioni i kërkimit, Projekteve dhe Botimeve shkencore (1 studentë), Komisioni i Marëdhënieve me student (1 student), Komisioni i sigurimit të cilësisë dhe kurikulave (1 student); Këshillin e etikës dhe Njësinë e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë (1 student). Gjithashtu, studentët janë të organizuar në përputhje me LAL dhe në Këshillin studentor për secilin Fakulet (FVFR me 6 anëtarë, një kryetar dhe dy zëvendës) i cili funksionon mbi bazën e një rregulloreje. Evidenca II.3 – Informacion nga Komisioni Kurikulës Tabela Nr.24 – Të dhëna anëtarët e NJSBC Evidenca II.19 – Vendimi konstituimit të Këshilli Studentor Evidenca II.18 – Lista e anëtarëve student në Senatin Akademik Evidenca II.19.1 – Rregullore e Këshillit Studentor
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose	GVJ konstaton se UST ka garantuar përfshirjen e studentëve dhe përfaqësimit të tyre në organet kolegjiale vendimmarrëse (shih kriterin 1) por dhe në komisione apo zyra të cilat kanë një rol në

përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	procesin mësimor si dhe garantimin e sigurisë së cilësisë së tij, si psh: Komisioni i kërkimit, Projekteve dhe Botimeve shkencore (1 studentë), Komisioni i Marrëdhënieve me student (1 student), Komisioni i sigurimit të cilësisë dhe kurikulave (1 student); Këshillin e etikës dhe Njësine e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë (1 student). Studentët janë të përfshirë në raportimet e punës së këtyre komisioneve. <i>Evidenca II.3 – Informacion nga Komisioni Kurikulës</i> <i>Tabela Nr.24 – Të dhëna anëtarët e NJSBC</i> <i>Evidenca II.19 – Vendimi konstituimit të Këshilli Studentor</i> <i>Evidenca II.18 – Lista e anëtarëve student në Senatin Akademik</i> <i>Evidenca V.9 – Kostituimi Komisionit Marrëdhënie me Studentët</i> <i>Evidenca V.9.2 – Raport I punës së Komisionit Marrëdhënie me</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ konstaton se DMST garanton përfshirjen e studentëve në procesin e marrjes së vendimeve, këshillimin ose vlerësimin e procesit akademik në Takimet e Komisionit të Kurikulës ku diskutohet në mënyrë periodike lidhur me ndryshimet e Kurrikulës për Programin MP në Mënaxhim Sporti dhe Turizëm. Gjithashtu, DMST në bashkëpunim me NJSBC, përfshin studentët në proceset e hartimit të raporteve të vlerësimit të brendshëm të programit në funksion të akreditimit, po ashtu dhe në hartimin, shpërndarjen dhe plotësimin e pyetësorëve për cilësinë e programeve të studimit dhe personelit akademik. <i>Evidenca II.3 – Informacion nga Komisioni Kurikulës</i> <i>Evidenca III.5 – Pyetësor studentor</i> <i>Evidenca III.6 – Raport Vjetor NJSBC</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatatit, rishikimit dhe	GVJ konstaton se UST ka procedura të ankimimit lidhur me rezultatin e kontrollit të dijeve të cilat janë të përcaktuara në pëpruthje me ligjin në fuqi në aktet rregullative të IAL dhe njësive kryesore FVFR. <i>Evidenca I.6 – Rregullore e Universitetit (Neni 102)</i> <i>Evidenca I.22 – Rregullore e FVFR</i>



reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.				
Konkluzione	GVJ konstaton se UST përfshin studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të përmirësimit të kurikulës dhe sigurimit të cilësisë për programin e studimit MP në Menaxhim Sporti dhe Turizëm. GVJ konstaton se UST ka garantuar përfshirjen e studentëve dhe përfaqësimit të tyre në organet kolegjiale vendimmarrëse por dhe në komisione apo zyra të cilat kanë një rol në procesin mësimor si dhe garantimin e sigurisë së cilësisë së tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ konstaton se UST ka një disa struktura të posaçme për informimin dhe orientimin e studentëve lidhur me procesin mësimor, orientimin e studentëve të rinj, kurikulat, diplomën, dhe mundësitë e punësimit, info day, trajnime, takime të hapura, si: Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët që në bashkëpunim me Komisionin me Marrëdhëniet me Studentët, por dhe sekretaria mësimore gjithashtu. <u>https://ust.edu.al/drejtoria-e-marredhenieve-me-jashte-publikun-dhe-studentet/informacion/</u> Evidenca I.13 – Informacion nga Sektori i karrieres dhe Alumni Evidenca V.9.1- Rregullore e Komisionit të Studentëve
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të	Gjithashtu, informimi realizohet përmes Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digitalizimit që nëpërmjet varësisë së Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit dhe Sekretarisë Mësimore Digjitale i ofrojnë studentëve asistencën në lidhje me regjistrimin, ecurinë akademike, diplomimin, detyrimeve dhe pjesëmarrje në mobilitete.

bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<i>Evidenca I.1 – Statuti i Universitetit (Neni 31)</i> <i>Evidenca III.15 – Rregulore e Sekerretarisë Mësimore digjitale</i> https://ust.edu.al/drejtoria-e-zhvillimit-te-programeve-dhe-digjitalizimit-te-sherbimeve-akademiko-shkencore/informacion-dzhpdsash/
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	GVJ konstaton se ka një strukturë të posaçme Sektori i Alumnit dhe Karrierës dhe Marrëdhënieve me Studentët e cila ofron shërbime për studentët lidhur me zhvillimin e karrierës dhe Edukimit të Vazhduar me qëllim aftësimin e tyre profesional për të qenë proaktiv me kërkesat e tregut të punës brenda dhe jashtë vendit. Zyra e realizon këtë përmes takimeve për këshillimin e karrierës duke përfshirë: evente, takime, intervista me punëdhënës potencialë në nivel lokal dhe qendror. Zyra bashkëpunon me DMST për orientimin e studentëve në kuadër të praktikave mësimore. <i>Evidenca I.13 – Informacion nga Sektori i karrieres dhe Alumnit</i> <i>Evidenca II.V.2 – Aktivitete me tregun e punës</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Sektori i Alumnit dhe Karrierës dhe Marrëdhënieve me Studentët mbledh dhe përpunon të dhënat e studentëve lidhur me punësimin e tyre pas diplomimit. Sipas Raportit Alumni 2022-2024, ku për programin Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm për periudhën 2022-2023 nga 15 të diplomuar 9 studentë janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 4 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën; ndërsa për periudhën 2023-2024 nga 16 të diplomuar 8 studentë janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 6 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën. Të dhënat e analizuara përcillen te drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore. <i>Evidenca II.16 – Informacion nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë</i> <i>Evidenca II.16.1. – Të dhëna statistikore nga sektori alumni mbi ecurinë e punësimit</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se UST ka krijuar procedura dhe zyra të posaçme me qëllim pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve dhe problematikave, dhe që janë lehtësisht të menaxhueshme dhe të prekshme nga studentët e

	<i>programit të studimit MP në Menaxhim Sporti dhe Turizëm. Sektori i Alumnit dhe Karrierës dhe Marrëdhënieve me Studentët mbledh dhe përpunon të dhënat e studentëve lidhur me punësimin e tyre pas diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ konstaton se UST ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies, të tillë si: udhëzuesi për mësimin në distancë për personelin; udhëzuesi për mësimin në distancë për studentët dhe udhëzuesi për vlerësimin në distancë. <i>GVJ rekomandon përfshirjen e trajnimeve për personelin akademik lidhur me zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies në fushën e menaxhimit të sportit dhe turizimit.</i> <i>Evidenca III.1.1;1.2 – Udhëzues për mësimin në distancë për personelin/studentin</i> <i>Evidenca III.3.2 – Udhëzues për politikën e vlerësimit në distancë</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	UST ka të ngritur një strukturë, Njësinë e Sigurisë së Brendshme të Cilësisë (NJSBC) e cila është ngritur me vendim SA dhe bazuar në Statutin dhe manualin e funksionimit kryen procesin periodik të vlerësimit të cilësisë së veprimtarive mësimore kërmikomore të programeve të studimit dhe të vlerësimit të brendshme institucional. NJSBC ka në përbërjen e saj 7 anëtarë ku njëri prej tyre është

	përfaqësues student. <i>Evidenca VI.1 – Vendimi SA për riorganizimin e NJSBC</i> <i>Evidenca VI.1.1 – Manual i funksionimit të NJSBC</i> <i>Tabela Nr.24 – Të dhëna për anëtarët e NJSBC</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	UST garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve. NJSBC ka në përbërjen e saj 7 anëtarë ku njëri prej tyre është përfaqësues student. Përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë realizohet përmes përfshirjes në procesin e anketimit për cilësinë e mësimdhënies; pjesëmarrjes së përfaqësuesve në orhganet e larta vendimmarrëse; pjesëmarrjes në grupet e vlerësimit të brendshëm etj. Gjithashtu, ka procedurë të vecantë për ankimimet e studentëve, dhe menyrën e zgjidhjes së tyre. <i>Evidenca VI.1 – Vendimi SA për riorganizimin e NJSBC</i> <i>Evidenca III.5 – Pyetësori studentëve</i> <i>Evidenca II.18 – Lista e studentëve në SA dhe Komisionet</i> <i>Evidenca V.10 – Urdhër për GVB programi MP Menaxhim Sport dhe Turizëm</i> <i>Evidenca I.6 – Rregulore e UST (neni 102)</i>

Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ konstaton se NJSBC bazuar në Rregulloren e njësisë dhe Planin e veprimit e saj, harton dhe bën publike rezultatet e vlerësimit së bashku me rekomandimet përkatëse. <i>GVJ rekomandon vijmësinë e përditësimit dhe bërjen publike në faqen web për V.A 2023 dhe 2024 të raportimit të NJSBC në funksion të transparencës për studentët dhe publikun.</i> Evidenca I.16 – Raporti vjetor UST 2022-2023 <u>https://ust.edu.al/veprimtaria-dhe-aktivitetet-njesia-a-sigurimit-tSe-brendshem-te-cilesise/</u>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ konstaton se përdor vlerësimet e përftuara nga Raportimet vjetore të NJSBC në raportimet vjetore të njësisë bazë DMST, njësisë kryesore FVFR dhe në rang institucional. Nga Raporti vjetor i NJSBC, referuar veprimtarive të FVFR, janë evidentuar pikat e forta dhe pikat e dobëta dhe për rrjedhojë praktikave të mira dhe nevojat për përmirësime si: mbështetje dhe inkurajim për botimin e teksteve në shqip; mbështetje dhe inkurajim stafit për projekte kërkimore për inçakt të gjere; zhvillimin e studimeve eksperimentale; mbështetje stafit për kualifikimin me grada dhe tituj akademike etj. Evidenca III.6 – Raportim vjetor NJSBC Evidenca I.16.1 – Raporti vjetor i veprimtarisë mwsimorë-kërkimore FVFR 2022-2023 Evidenca I.16.2 – Raporti vjetor i veprimtarisë mwsimorë-kërkimore DMST 2022-2023			
Konkluzione	GVJ konstaton se UST disponon dhe zbaton politika dhe procedura për garantimin e cilësisë së mësimdhënies si dhe harton formularë të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. GVJ rekomandon përfshirjen e trajnimeve për personelin akademik lidhur me zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies në fushën e menaxhimit të sportit dhe turizimit si dhe vijmësinë e përditësimit dhe bërjen publike në faqen eeb për V.A 2023 dhe 2024 të raportimit të NJSBC në funksion të transparencës për studentët dhe publikun			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht




				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në UST ka strukturë të posaçme, Njesia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. Gjithashtu ka procedura, manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë në UST është konceptuar dhe funksionon në përputhje me standardet dhe udhëzimet për sigurimin të Arsimit të Lartë sipas Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, NJBSC ka vepruar si një njësi organizative e përhershme dhe aktualisht, në UST vepron NJBSC me përbërje sipas Vendimit të Senatit Akademik Nr. 93, 19.05.2021. NJSBC ka në përbërjen e saj 7 anëtarë ku njëri prej tyre është përfaqësues student, D. Balla. <i>Evidenca VI.1 – Vendimi SA për riorganizimin e NJSBC</i> <i>Evidenca VI.1.1 – Manual i funksionimit të NJSBC</i> <i>Tabela Nr.24 – Të dhëna për anëtarët e NJSBC</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	UST në përbërje të strukturës së tij organizative ka të ngritur, dhe mban në funksion zyrën e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. NJBSC me aktivitetin e saj synon në mënyrë të vazhdueshme përmirësimin e cilësisë. UST ka hartuar politika dhe një strategji institucionale 2021-2026 për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në këtë zyrë aktivizohen, përveç, stafit akademik edhe studentët dhe bashkëpunëtorë të jashtëm bazuar në marrëveshjet të bashkëpunimit që UST ka me institucione homolege dhe aktorë të tregut të punës. Funksionimi i NJSBC garantohej nga statuti i UST dhe Manuali i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të hartuar në përputhje me Kodin e cilësisë për arsimin e lartë të gjithë periudhën e funksionimit të saj NJBSC përbëhet nga burimet e nevojshme njerëzore, në mënyrë që të jetë në gjendje të zbatojë të gjitha objektivat dhe funksionet e saj.



	Anetarë të njësisë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë pjesëtarë me eksperiencë të personelit akademik nga fakultetet aktuale si edhe përfaqësues të studentëve. <i>Evidenca I.1 – Statuti (neni 29)</i> <i>Evidenca I.2 – Plan i strategjik i zhvillimit UST 2021-2026</i> <i>Evidenca VI.1 – Vendimi SA për riorganizimin e NJSBC</i> <i>Evidenca VI.1.1 – Manual i funksionimit të NJSBC</i> <i>Tabela Nr.24 – Të dhëna për anëtarët e NJSBC</i> <i>Evidenca III.6 – Raportim vjetor NJSBC</i> <i>Evidenca I.19.1 – Lista e marrëveshjeve</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	UST për sigurimin e cilësisë mbështetet në përpilimin e Raportit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë si dhe Raportit vjetor të NJSBC. Ai përdor instrumentat duke u mbështetur në standardet dhe kriteret e legjislacionit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. NJSBC ka si funksion kryesor garantimin e cilësisë, përmirësimin e vazhdueshëm të saj në aritjen e objektivave të përcaktuara. UST përgjatë viteve të zhvillimit të veprimtarisë së tij i është nënshtruar procesit të akreditimit periodik ku akreditimin e fundit institucional e ka marrë me Vendim Nr.2/07.01.2022 të BA ASCA me 6 (gjashtë) vite akademike. Të gjitha vetëvlerësimet e brendshme dhe vlerësimet e jashtme në UST bëhen duke u mbështetur në dokumenta, procedura, anketime, si edhe takime me palët e interesuara. Këto akreditime nëpërmjet Raportëve të Ekspertëve të Jashtëm të Cilësisë dhe vlerësimeve të tyre kanë kontribuar për sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve mësimore të UST. UST ka miratuar dhe ngritjen e GVB për programin MP në Menaxhim Sporti dhe Turizëm, me 5 (pesë) antarë ku 1 (një) është student dhe dy (dy) prej tyre janë anëtarë të NJSBC. <i>Evidenca I.9 – Vendimi akreditimi institucional</i> <i>Evidenca V.10 – Urdhër për GVB programi MP Menaxhim Sport dhe Turizëm</i> <i>Evidenca VI.1 – Vendimi SA për riorganizimin e NJSBC</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm	Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues përmes pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e

në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	cdo programi studimi. Pyestësorët organizohen dhe monitotohen në mënyrë periodike nga NJBSC gjatë vitit dhe rezultatet e tyre raportohen në Raportin Vjetor të NJSBC i cili i raportohet Rektorit dhe për më pas për analizë prane drejtuesve të departamenteve, të fakulteteve ku rekomandohen detyra, si pikë referimi për përmirësimin e cilësisë. https://ust.edu.al/wp-content/uploads/2021/05/Manuali-NJSBC.pdf <i>Evidence III.6 – Raportim vjetor NJSBC</i> <i>Evidenca II.13 – Informacion nga Komisioni Kurikulës</i> <i>Evidenca III.5 – Pyetësori studentëve</i>			
Konkluzione	GVJ se UST harton dhe zbaton politika e procedura transparente për sigurimin e cilësisë së programit të studimit MP në Menaxhim Sporti dhe Turizëm në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Pyestësorët organizohen dhe monitotohen në mënyrë periodike nga NJBSC gjatë vitit dhe rezultatet e tyre raportohen në Raportin Vjetor të NJSBC i cili i raportohet Rektorit dhe për më pas për analizë prane drejtuesve të departamenteve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e	GVJ konstaton se UST harton cdo vit raportin lidhur me procesin mësimor dhe kërkimor si dhe për përmirësimin e kurikulave. Raportimi vjetor bazohet në analizën raportuese të njësive këryesore, njësive bazë dhe NJSBC-së. Gjithashtu, në mënyrë periodike janë zhvilluar pyetësorët e studentëve me fokus cilësinë e programeve të studimit dhe evidentimin e pikave të forta dhe të dobëta si dhe promovimin e praktikave të mira. <i>Evidence III.6 – Raportim vjetor NJSBC</i>

arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Evidenca II.13 – Informacion nga Komisioni Kurikulës Evidenca III.5 – Pyetësori studentëve Evidenca I.16.1 – Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore FVFR 2022-2023 Evidenca I.16.2 – Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore DMST 2022-2023
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ konstaton se përdoren tregues të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim për pasqyrimin dhe përmirësimin e cilësisë. Për të vlerësuar cilësinë e programit, përveç analizës së pyetësoreve drejtuar studentëve janë hartuar dhe propozimë dhe rekomandime për përmirësimin e kurikulës, si Plan veprimi i Komisionit të Kurikulës për V.A 2024-2025 me listimin e veprimtarive dhe njësive përgjegjëse, drejtuarit Rektorit të UST, nr.3877/2, prot.; dt.18.12.2024. Evidenca II.13 – Informacion nga Komisioni Kurikulës
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i	GVJ konstaton se UST harton cdo vit raportin lidhur me procesin mësimor dhe kërkimor bazuar në analizën raportuese të njësive këryesore FVFR dhe njësisë bazë përgjegjëse për programin, DMST. Ghithashtu, referuar planit vjetor të NJSBC por dhe analizës, ka disa metoda të drejteperdreja si takimet me fokus grupet apo dhe me alumni për të vlerësuar cilësinë e programit të studimit. Për të vlerësuar cilësinë e programit janë hartuar propozime dhe rekomandime për përmirësimin e kurikulës, si Plan veprimi i Komisionit të Kurikulës për V.A 2024-2025 me listimin e veprimtarive dhe njësive përgjegjëse, drejtuarit Rektorit të UST, nr.3877/2, prot.; dt.18.12.2024. Evidenca II.13 – Informacion nga Komisioni Kurikulës Evidenca I.16.1 – Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore FVFR 2022-2023 Evidenca I.16.2 – Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore DMST 2022-2023

shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.				
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	GVJ konstaton se përdoren metoda të tërthorta vlerësimi si pyetësorët e studentëve, takime në fokus grupe si dhe intervistime nga drejtorja e marrëdhënieve me jashtë, publikut dhe studentëve (sektori alumni) me studentë alumni si Raporti Alumni 2022-2024, ku për programin Master Profesional në Menaxhim Sporti dhe Turizëm për periudhën 2022-2023 nga 15 të diplomuar 9 studentë janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 4 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën; ndërsa për periudhën 2023-2024 nga 16 të diplomuar 8 studentë janë të punësuar në përputhje me diplomën dhe 6 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën. <i>Evidenca III.5 – Pyetësi studentëve</i> <i>Evidenca II.16 – Informacion nga Drejtorja e Marrëdhënieve me Jashtë</i> <i>Evidenca II.16.1 – Të dhëna statistikore nga sektori i alumnit për ecurine e punësimit 2022-2024</i>			
Konkluzione	GVJ vëren se UST monitoron periodikisht cilësinë dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve. NJSBC përdor instrumenta të drejtperdrejta dhe të tërthorta për të kuptuar gjëndjen aktuale të programit të studimit, dhe dilet me një plan masash me qëllim përmirësimin e tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitet akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe	GVJ konstaton se UST ka të ngritur, dhe mban në funksion zyrën e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë NJSBC që me aktivitetin e saj synon në mënyrë të vazhdueshme përmirësimin e

procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	cilësisë. UST ka hartuar politika dhe një strategji institucionale 2021-2026 për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në këtë zyrë aktivizohen, përveç, stafit akademik edhe studentët si dhe konsultohen dhe bashkëpunetorë të jashtëm bazuar në marrëveshjet të bashkëpunimit që UST ka me institucione homolege dhe aktorë të tregut të punës. GVJ konstaton se DMST si njësi bazë përgjegjëse për programin MP ka ndërmarrë dhe studime të mirëfillta tregu lidhur me zhvillimin e turizmit sportiv në shqipëri dhe rajon, si psh studimi “Turizmi aktiv dhe prespektiva e zhvillimit të tij në tregun shqiptar dhe ne rajon” drejtuar Kryetarit të Senatit në korrik 2023. Evidenca VI.1 – Vendimi SA për riorganizimin e NJSBC Evidenca VI.1.1 – Manual i funksionimit të NJSBC Tabela Nr.24 – Të dhëna për anëtarët e NJSBC II.17 – Analiza e tregut të punë – Raport i projektit të DMST
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ konstaton se Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë në UST është konceptuar dhe funksionon në përputhje me standardet dhe udhëzimet për sigurimin të Arsimit të Lartë sipas Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, NJSBC ka vepruar si një njësi organizative e përhershme dhe aktualisht, në UST vepron NJSBC me përbërje sipas Vendimit të Senatit Akademik Nr. 93, 19.05.2021. NJSBC ka në përbërjen e saj 7 anëtarë ku njëri prej tyre është përfaqësues student, D. Balla. Evidenca VI.1 – Vendimi SA për riorganizimin e NJSBC Evidenca VI.1.1 – Manual i funksionimit të NJSBC Tabela Nr.24 – Të dhëna për anëtarët e NJSBC
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e	UST garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve. GVJ ka në përbërjen e saj 7 anëtarë ku 2 (dy) anëtare janë anëtarë të DMST (përgj. Departamentit Dr. E. Kushta dhe PAE, Doc. A. Lile) dhe njëri prej tyre është përfaqësues student, D. Balla. Përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë realizohet përmes përfshirjes në procesin e anketimit për cilësinë e mësimdhënies; pjesëmarrjes së përfaqësuesve në orhganet e larta vendimmarrëse; pjesëmarrjes në grupet e vlerësimit të brendshëm etj.

administrative dhe studentëve të programit të studimit.	<i>Evidenca VI.1 – Vendimi SA për riorganizimin e NJSBC</i> <i>Evidenca III.5 – Pyetësi studentëve</i> <i>Evidenca II.18 – Lista e studentëve në SA dhe Komisionet</i> <i>Evidenca V.10 – Urdhër për GVB programi MP Menaxhim Sport dhe Turizëm</i> <i>Tabela Nr.24 – Të dhëna për anëtarët e NJSBC</i>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit të cilësisë në UST respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Koordinimi i procesit të vlerësimit është përgjegjësi e Drejtuesit të departamentit dhe NJSBC. <i>Evidenca III.11 – Rregulore e këshillit të etikës të UST</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	UST ka hartuar politika dhe disa strategji, si strategjia institucionale 2021-2026 dhe strategjia për ndërkombëtarizimin 2024-2028 për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. NJSBC aktivizon, përvec, stafit akademik edhe studentët si dhe konsulton dhe bashkëpunëtorë të jashtëm bazuar në marrëveshjet të bashkëpunimit që UST ka me institucione homologe dhe aktorë të tregut të punës. <i>Evidenca I.2 – Plan i strategjik i zhvillimit UST 2021-2026</i> <i>Evidenca I.19 – Strategjia e ndërkombëtarizimit UST, 2024-2028</i> <i>Evidenca I.19 – Lista e marrëveshjeve</i> <i>Evidenca V.2 – Aktivitete me tregun e punës</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se UST ka politika të qarta për promovimin dhe sigurimin e cilësisë si dhe përfshirjen e aktorëve të brendshëm të IAL në këtë proces. NJSBC aktivizon, përvec, stafit akademik edhe studentët si dhe konsulton dhe bashkëpunëtorë të jashtëm bazuar në marrëveshjet të bashkëpunimit që UST ka me institucione homologe dhe aktorë të tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UST garanton transparencën dhe bërjen publike të veprimtarisë në faqen web të UST në kuadër të sistemit të NJSBC, planet strategjike; veprimtaritë akademike, kërkimore-shkencore; Raporte monitorimi për programet e studimit; raporte të vlerësimit të performancës. https://ust.edu.al/programi-i-transparences/
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	UST në publikimin e rezultateve, respekton lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. <i>Evidenca III.11 – Rregulore e këshillit të etikës të UST</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	NJSBC në procedurën e analizës së pyetësorëve ndjek miratimin e Raportit në Senat Akademik. Raportit i bashkangjiten rekomandimet të cilat i adresohen strukturave dhe më pas hartohet plani i masave për përmirësimin e cilësisë që miratohen në rektorat. <i>Evidenca VI.1.2 – Plan veprimi NJSBC</i> <i>Evidenca III.6 – Raportim vjetor NJSBC</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Programet e studimit në UST rishikohen për qëllime të akreditimit të programit me ASCAL. Programi MP në “Menaxhim Sporti dhe Turizëm” është subjekt riakreditimi pasi akreditimin e parë është marrë me Vendim Nr. 25, datë 13.07.2018. Rezultatet e vlerësimit kontribuojnë në përshtatjen e kurrikulave për të mbështetur efikasitetin e mësimdhënies dhe për të siguruar cilësinë e kurrikulës. <i>Evidenca III.6 – Raportim vjetor NJSBC</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari	Përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë garantohet nga përfshirja e tyre në




periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	strukturat e garantimit të cilësisë. Informacioni për studentët shpërndahet nëpërmjet, rregulloreve, studentëve të përfshirë në struktura të ndryshme brenda institucionit (NJBSC, Senati Akademik dhe Komisionet, Këshilli studentor, Zyra e karrierës dhe Alumni etj. Java e orientimit-që zhvillohet në fillim të vitit akademik. <i>Evidenca I.13 – Informacioni nga Sektori i Karrierës dhe Alumni</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se UST zhvillon procese dhe veprimtari të cilat janë publike dhe në tërësi efikase për krijimi dhe institucionalizimin e një kulture cilësie dhe përmirësimi të vazhdueshëm të programit të studimit. Ky program I nënshtrohet për herë të dytë akreditimit, si një mënyrë garantimi të cilësisë së programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Sporteve të Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, specifikisht Departamenti i Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit, nëpërmjet stafit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve, jep kontributin e tij në fushën e menaxhimit në sport dhe turizëm, si një program unik i llojit të tij në vend.
2. Programi Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” dallohet për cilësinë dhe qasjen ndërdisiplinore, duke ofruar përgatitje të specializuar në dy sektorë me rritje të shpejtë. Programi formon profesionistë të aftë për të menaxhuar dhe zhvilluar aktivitete sportive e turistike në mënyrë të qëndrueshme dhe inovative.
3. Programi është ndërtuar në përputhje me vizionin, misionin e institucionit, nevojat e tregut, objektivat e reformës së arsimit të lartë në vend dhe të Procesit të Bolonjës dhe ka të integruar përvojën më të mirë bashkëkohore të huaj dhe vendase. Planit mësimor, syllabuset metodat e mësimdhënies e mësimnxënies janë sipas kërkesave të standardeve akademike.
4. Ambjentet fizike, terrenet dhe ato laboratorike të Universitetit të Sporteve të Tiranës, specifikisht të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit janë bashkëkohore, të rikonstruktura dhe të përshatshme për realizimin e misionit të tij.
5. Universiteti dhe njësia kryesore kanë një bashkëpunim të institucionalizuar me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi UST realizon me sukses objektivat për kërkimin shkencor, shkëmbimin e eksperiencave dhe punësimin e garantuar të të diplomuarve në këtë program studimi.
6. UST në rastin e programit të studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm, ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës praktikës profesionale, praktikave dhe stazheve të cilat me të drejtë ky program studimi i ka shtrirë gjatë gjithë vitit akademik pra tek të dy semestrat. Numri i lartë por dhe cilësor i marrëveshjeve të bashkëpunimit të UST me partnerët publikë dhe privatë mundëson realizimin e praktikave profesionale që sigurojnë përfitime shumë të mira të njohurive dhe kompetencave profesionale.

Pika të dobëta

1. Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit ka bibliotekë jo shumë të pasur për këtë program studimi ndaj ka nevojë për blerje titujsh të rinj bashkëkohorë kryesisht leading books të 5 viteve të fundit. (*Standard II.3, Kriteri 4; Standard II.4, Kriteri 5*)



2. Duhet të ketë më tepër avancime/kualifikime/botime mbi menaxhimin në sport dhe turizëm në revista të indeksuara për personelin akademik pse jo edhe me përfshirjen e studentëve të ekselencës. *(Standard II.7, Kriteri 3)*

Rekomandime

1. GVJ rekomandon se duhet të ketë më tepër trajnime për metodat e avancuara të mësimdhënies për personelin akademik.
2. GVJ rekomandon që në syllabuse të bëhet formatizimi i njëjtë si dhe të vendosen rezultatet e mësimdhënies, kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti. Sugjerojmë që syllabet pas këtij akreditimi të përditësohen me synime të qarta për përmirësimin e tyre në të ardhmen në favor të një mësimdhënie më cilësore. Mos të harrojmë se kemi autorë shqiptarë autoritete të padiskutueshme në fushën menaxhimit të sportit dhe turizmit që kanë tekste universitare të shkëlqyera dhe me vlera të pakundërshtueshme.
3. GVJ rekomandon që në të ardhmen Biblioteka e Fakultetit të Edukimit të pasurohet edhe më tepër me literature në disiplinën e menaxhimit në sport dhe turizëm.
4. GVJ rekomandon që DMST-ja duhet të bëjë më shumë në drejtim të nënshkrimit të marrëveshjeve me IAL të huaja të cilat ofrojnë programe studimi të njëjta apo të ngjashme e cila do të mundësonte funksionimin e mobiliteteve sidomos për studentët dhe stafet akademike në të ardhmen e afërt sidomos në këtë fazë ku është prioritet ndërkombëtarizimi i universiteteve shqiptare.
5. GVJ rekomandon që në të ardhmen të shikohet mundësia e transformimit të këtij masteri në master shkencor me 120 kredite ECTS.

Conclusions of the Evaluation of the Second Cycle Study Program Professional Master in “Sports and Tourism Management” provided by the Higher Education Institution “University of Sports of Tirana”

Strengths and affirmations

1. The Faculty of Physical Activity and Recreation, specifically the Department of Sport and Tourism Management, through its academic staff, academic assistants and students, contributes to the field of sport and tourism management, as a unique program of its kind in the country.
2. The Professional Master Program in “Sport and Tourism Management” is distinguished by its quality and interdisciplinary approach, offering specialized training in two rapidly growing sectors. The program trains professionals capable of managing and developing sports and tourism activities in a sustainable and innovative manner.



3. The program is built in accordance with the vision, mission of the institution, market needs, objectives of the higher education reform in the country and the Bologna Process and integrates the best contemporary foreign and domestic experience. The curriculum, syllabi, teaching and learning methods are in accordance with the requirements of academic standards.
4. The physical, terrain and laboratory environments of the University of Sports of Tirana, specifically of the Faculty of Physical Activity and Recreation are contemporary, reconstructed and suitable for the realization of its mission.
5. The University and the main unit have an institutionalized cooperation with homologous institutions inside and outside the country. Through this cooperation, UST successfully realizes the objectives for scientific research, exchange of experiences and guaranteed employment of graduates in this study program.
6. UST, in the case of the Professional Master in Management in Sports and Tourism study program, follows a clear procedure of applying knowledge through practice, professional practice, internships and internships which this study program has rightly extended throughout the academic year, i.e. to both semesters. The high number and quality of UST's cooperation agreements with public and private partners enable the realization of professional practices that provide very good benefits of professional knowledge and competencies.

Weaknesses

1. The Department of Physical Activity and Recreation has a not very rich library for this study program, so there is a need to purchase new contemporary titles, mainly leading books from the last 5 years. *(Standard II.3, Criterion 4; Standard II.4, Criterion 5)*
2. There should be more advancements/qualifications/publications on management in sports and tourism in indexed journals for academic staff, perhaps even with the inclusion of students of excellence. *(Standard II.7, Criterion 3)*

Recommendation

1. EEG recommends that there should be more training on advanced teaching methods for academic staff.
2. EEG recommends that the syllabi be formatted in the same way and that the teaching outcomes, competencies and skills acquired by the student be established. We suggest that the syllabi be updated after this accreditation with clear goals for their improvement in the future in favor of a more qualitative teaching. Let us not forget that we have Albanian authors who are indisputable authorities in the field of sports and tourism management who have excellent university texts with undisputed values.




3. EEG recommends that in the future the Library of the Faculty of Education be enriched even more with literature in the discipline of sports and tourism management.
4. EEG recommends that the DMST should do more in terms of signing agreements with foreign HEIs that offer the same or similar study programs, which would enable the functioning of mobilities, especially for students and academic staff, in the near future, especially at this stage where the internationalization of Albanian universities is a priority.
5. EEG recommends that in the future, the possibility of transforming this master's degree into a scientific master's degree with 120 ECTS credits be considered.

Two handwritten signatures in blue ink are located at the bottom of the page. The signature on the left is more stylized and cursive, while the one on the right is more formal and blocky.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

